



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Raport nga konferenca ndërkombëtare:

Digjitalizimi Tokësor Televiziv – **Praktikat Evropiane dhe Rajonale**

Prishtinë, 28-29 qershor 2012

Ky raport është përgaditur nga Bersant Disha (RECURA Financials) për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media në Kosovë. Raporti duhet të shërbejë vetëm për nevoja informuese dhe tenton të paraqesë diskutimet dhe konkluzionet nga konferenca ndërkombëtare mbi procesin e digjitalizimit të transmetimeve tokësore e organizuar në Kosovë. Raporti mund të përmbajë gabime të paqëllimta në shifra dhe fakte të prezentuara dhe duhet të shërbejë vetëm si përmbledhje e diskutimeve gjatë konferencës.

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Aktivitetet dhe puna e KPM-së rreth strategjisë së kalimit në transmetime digjitale	5
Digjitalizimi dhe mediat në Kosovë.....	6
Nga transmetimi analog në digjital – Perspektiva e përbashkët e Bashkimit Evropian	7
Nga tranmetimi analog në ate digjital – Përvojat rajonale	10
Shqipëria	11
Kroacia	13
Mali i Zi.....	14
Slovenia	15
Maqedonia	17
Turqia	18
Rregullimi i transmetimit në periudhën e digjitalizimit	19
Përparësitë dhe mangësitë në kalimin në transmetime digjitale	22
Pasurimi i ofertës programore dhe Dividenda Digjitale	25
Aneksi 1 – Fjala hyrëse nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës – z. Jakup Krasniqi.....	27
Aneksi 2 – Fjalimi i Shefes Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media	29
Aneksi 3 – Agjenda e Konferencës	31
Aneksi 4 - Prezentimet e folësve në konferencë	34

Hyrje

Në organizim të Komisionit të Pavarur për Media, më 28-29 qershor 2012 në Prishtinë u mbajt konferenca ndërkombëtare mbi Digjitalizimin e Transmetimeve Tokësore – Praktikrat Evropiane dhe Rajonale. Qëllimi i konferencës ishte prezantimi i procesit të digjitalizimit të transmetimeve, diskutimi i sfidave e përvojave praktike, teknike dhe ligjore në vendet Evropiane dhe ato nga rajoni me qëllim të ndarjes së përvojave nga ky proces. Në konferencë ishin prezent përfaqësues të institucioneve Kosovare, përfaqësues të medias Kosovare, përfaqësuesit e agjencioneve përkatëse nga vendet e rajonit, përfshi Kroacinë, Slloveninë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë, si dhe përfaqësues nga Britania e Madhe dhe Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullative (EPRA).

Konferenca u hap nga kryetari i parlamentit të Kosovës z. Jakup Krasniqi, i cili shprehu përkrahjen për konferencën dhe qëllimet e procesit si dhe shkëmbimin e përvojave me vendet e tjera. Ai e cilësoi këtë proces si të rëndësishëm për demokratizimin e mëtutjeshëm të shoqërisë përmes ofrimit dhe shpërndarjes së informacionit dhe si një proces të rëndësishëm në zhvillimin e mediave, biznesit dhe ekonomisë në Kosovë. Ai tha se konferenca po mbahet në kohën kur është kaluar Ligji mbi Komisionin e Pavarur për Media, i cili do të jetë bartës i këtij procesi. Në emër të Komisionit të Pavarur për Media, Drejtoresha Ekzekutive znj. Naile Selimaj-Krasniqi foli mbi rëndësinë e këtij procesi në Kosovë dhe më gjërë. Ajo shprehu nevojën e shkëmbimit të përvojave dhe mësimave nga ky proces me vendet e tjera, duke prezentuar sfidat kryesore të këtij procesi në Kosovë dhe stadin e zhvillimeve drejt kalimit në transmetime digjitale. Ajo tha se Kosova, pas kalimit të sfidave të mëdha në rregullimin e tregut mediatik në periudhën e pasluftës, tani gjendet në fillim të procesit të digjitalizimit dhe se kjo është tani sfida më e madhe posaçërisht nëse marrim parasysh pozitën e Kosovës në rafshin ndërkombëtar e sidomos pasojat e marrëveshjes Gjeneva 06 për transmetimet në Kosovë. Znj. Selimaj-Krasniqi tregoi se para pak kohësh Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin mbi Komisionin e Pavarur të Medias (KPM), ku KPM-ja definohet si bartëse e procesit të digjitalizimit. Ajo shprehu bindjen se Kuvendi i Kosovës së shpejti do të aprovojë edhe anëtarët e rinj të Këshillit të KPM-së, si organi më i lartë, dhe se me këtë do të hapet edhe rruga për përcaktimin e strategjisë së digjitalizimit në Kosovë si bazë për ndërmarrjen e hapave konkret drejt kalimit në transmetime digjitale. Znj. Selimaj-Krasniqi prezantoi edhe aktivitetet dhe punën e KPM-së në këtë drejtim dhe arritjen e deritanishme. Duke i përmbledhur sfidat kryesore që paraqiten para Kosovës, znj. Selimaj-Krasniqi shprehu falemnderimin e KPM-së për përkrahjen nga agjencionet simotra nga vendet e rajonit dhe më gjërë, si dhe për pjesëmarrjen në konferencë të përfaqësuesve nga këto vende.

Në konferencë fillimisht u prezentua gjendja aktuale e transmetimeve dhe mediave në Kosovë nga këndvështrimi i procesit të digjitalizimit. Pastaj, përfaqësuesit e Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullative (EPRA) dhe Grupit për Transmetime Digjitale (DTG) prezantuan përvojat Evropiane nga ky proces si dhe dilemat dhe sfidat kryesore që ky proces ngërthen. Më pas, përfaqësuesit nga vendet e rajonit paraqitën përvojat e tyre në procesin e kalimit nga transmetimi analog në atë digjital, ku qasjen e

ndryshme ndaj procesit u analizuan dhe u diskutuan mësimet nga këto procese. Konferenca përmbajti edhe 4 panel diskutime mbi temat specifike, të cilat përfshinë: Rregullimin e transmetimit në periudhën e digjitalizimit; Përparësitë dhe mangësitë e kalimit në transmetime digjitale; Pasurimin e ofertës programore; dhe Çështjet e Dividendës Digjitale, ku panelist ishin përfaqësuesit e autoriteteve rregullative nga vendet pjesëmarrëse në konferencë.

Aktivitetet dhe puna e KPM-së rreth strategjisë së kalimit në transmetime digjitale

Znj. Selimaj-Krasniqi foli për objektivat e KPM-së dhe aktivitetet e saj deri tani, me fokus në drejtim të procesit të digjitalizimit të transmetimeve tokësore në Kosovë. Ajo tregoi se KPM është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2005 si institucion i pavarur i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe rregullimin e brezit frekuencor për transmetime dhe licensimin e mediave publike dhe private. Ajo vazhdoi me prezentimin e zhvillimeve më të reja në Kosovë në procesin e digjitalizimit dhe me prezentimin e amandamenteve në Ligjin mbi Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), i cili tani parasheh KPM-në si bartëse kryesore të procesit të digjitalizimit.

Znj. Selimaj-Krasniqi foli edhe për sfidat specifike të Kosovës në këtë proces që dalin nga mos-përfshirja e Kosovës në konferencën për planifikimin frekuencor Gjeneva 2006 dhe problemet që dalin nga kjo. U theksua se çështja e alokimeve frekuencore për Kosovën duhet zgjidhet në bashkëpunim me vendet fqinje dhe të arrihet një mirëkuptim që do të plotësonte nevojat e Kosovës dhe do të mundësonte kalimin në transmetime digjitale në mënyrë të koordinuar. Relacionet me Sërbinë u theksuan si më problematike në këtë drejtim. Si pjesë e procesit të digjitalizimit, si një proces ndërkombëtar, znj. Selimaj-Krasniqi foli edhe për konferencat e mëhershme mbi digjitalizimin të mbajtura në organizim të KPM-së në Kosovë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe koordinimit sa më të mirë në këtë proces. Ajo tregoi se në vitin 2009, KPM-ja përmes ekspertëve të saj ka përpiluar një plan alternativ frekuencor që do të plotësonte nevojat e Kosovës dhe qytetarëve të saj, duke marrë parasysh përcaktimet nga Gjeneva 2006, diskutimet me autoritetet rregullative nga vendet fqinje, si dhe qasjen e zhvillimit të një plani frekuencor që do të shkaktonte sa më pak pengesa dhe ndryshime në planet e vendeve fqinje.

Pastaj, u prezentuan edhe problemet e KPM-së në zhvillimin e veprimtarisë së saj si pasojë e vonësive të deritanishme në amandamentimin e Ligjit mbi KPM-në dhe mos emërimin e anëtarëve të rinj me mandat të plotë në Këshillin e KPM-së, që për pasojë ka sjellë deri te pamundësia e marrjes së vendimeve nga Këshilli i KPM-së për gati dy vite, gjë që ka bllokuar edhe procesin e digjitalizimit. Ajo theksoi shpresën se Kuvendi i Kosovës do të emrojë së shpejti anëtarët e Këshillit dhe se kjo do të mundësojë zhvillimin e plotë të aktiviteteve të KPM-së.

Si pjesë e procesit të digjitalizimit në Kosovë, znj. Selimaj-Krasniqi përmendi edhe krijimin e dy mekanizmave koordinues, atij të brendshëm në mes të akterëve të ndryshëm në Kosovë përfshi mediat,

autoritetet rregullative dhe qeverinë, dhe mekanizmin rajonal për koordinim në mes të vendeve fqinje. Mekanizmi i brendshëm koordinues përfshinë aktivitetin e lehtësuar nga KPM përmes krijimit të 5 grupeve punuese tematike, të cilat mbulojnë fushat që duhet të reflektohen në strategji: Korniza Ligjore; Aspekti Teknik; Çështjet e përmbajtjes programore; Çështjet e fizibilitetit ekonomik; dhe Çështjet e informimit dhe edukimit të qytetarëve mbi procesin e kalimit në transmetime digjitale. Grupet përbëhen nga ekspertë të fushave përkatëse, përfaqësues të mediave të licensuara për transmetime në Kosovë, përfaqësues nga Univerzitetit dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si dhe përfaqësues të autoriteteve përkatëse publike që rregullojnë fushat specifike. Puna e grupeve punuese ka filluar nga viti 2010, mirëpo sipas znj. Selimaj-Krasniqi intensitetit i punës ka qenë i ulët si pasojë e mos-funksionimit të Këshillit të KPM-së për të aprovuar zgjidhjet e propozuara. Tani, KPM-ja ka përpiluar draftin e parë të strategjisë që do të jetë edhe bazë për disejnimin e strategjisë finale. Znj. Selimaj-Krasniqi përmendi edhe ndihmën e dhënë për këtë provces nga misioni i OSBE-së në Kosovë, IREX-i si dhe Komisioni Evropian.

Znj. Selimaj-Krasniqi përfundoi duke prezentuar planin e punës drejt digjitalizimit të transmetimeve duke thënë se drafti i strategjisë parasheh se Kosova do të përdorë 7 kanale për transmetim digjital dhe se përmes strategjisë do të sigurohet pluralizmi i mediave, krijohet mundësia për zhvillim ekonomik, duke e bërë këtë me kosto sa më të ulët për shoqërinë. Strategjia finale përdigjitalizim duhet të aprovohet nga Qeveria e Kosovës e në bazë të saj të hartohet edhe Ligji Administrativ për Digjitalizimin.

Digjitalizimi dhe mediat në Kosovë

Mbi procesin e digjitalizimit në Kosovë dhe këndvështrimin e mediave folën z. Mentor Shala, zëvendës drejtor gjeneral i Radio Televizionit të Kosovës (RTK – transmetues publik) dhe z. Visar Hoti nga Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës (AMPEK).

z. Shala shprehu shqetësimin se Kosovë është shumë prapa me procesin e digjitalizimit, si në aspektin teknologjik, ashtu edhe në atë ligjor. Afati i caktuar në konferencën Gjeneva 2006 përcakton mesin e vitit 2015 si afat për kalim të plotë në transmetime digjitale, gjë që është shumë afër. Sipas z. Shala, Kosova ka dy faktorë që e limitojnë mundësinë e lëvizjes së shpejtë në këtë proces, e ata janë kostoja e lartë e kalimit në transmetime digjitale dhe koha e limituar për përfundimin e këtij procesi. Ai theksoi nevojën e ndihmës institucionale në këtë drejtim dhe theksoi se Kuvendi i Kosovës ka një rol të veçantë në këtë drejtim. Ai tha se edhe pse KPM-ja ka filluar të punojë në hartimin e strategjisë për digjitalizim, janë bërë pak hapa konkret drejt digjitalizimit si pasojë e mandatit të Këshillit të KPM-së. Ai poashtu shprehu shqetësimin e zvarritja e ligjit mbi RTK-në ka shkaktuar kokëçarje shtesë për transmetuesin publik drejt përgaditjes për transmetime digjitale. Këtu ai përmendi çështjen e paqartësisë rreth pronave të RTK-së dhe pengesën që kjo çështje paraqet për marrjen e vendimeve për investime në ndryshimin e teknologjisë, të cilat janë shumë të larta dhe nuk mund të bëhen me pasiguri rreth pronës.

Ai theksoi se RTK-ja dhe të gjithë transmetuesit e tjerë duhet të konsiderojnë bashkëpunimin e ngushte në këtë proces dhe investimin në një rrjet të përbashkët transmetues digjital ashtu që të ndahen kostot dhe që kjo gjë të bëhet më e arritshme financiarisht duke mbrojtur edhe interesat e transmetuesve Kosovar. Në fund, z. Shala shprehu nevojën për përshejtimin e procesit përmes angazhimit më të madh të të gjithë hisenikëve, përfshi këtu Kuvendin e Kosovës, Qeverinë, transmetuesit dhe autoritetet rregullative.

Në emër të AMPEK-ut foli z. Visar Hoti, i cili fillimisht u fokusua në pozitën e disfavorshme në të cilën gjendet Kosova si pasojë e moslejimit të pjesëmarrjes në konferencën Gjeneva 2006, gjë që ka shkaktuar probleme si për autoritetet rregullative ashtu edhe për transmetuesit. Sipas z. Hoti kjo është një privim i Kosovës nga resurset e saj natyrore. Prandaj duhet bërë maksimumin që Kosovës ti kthehen frekuencat e saj që do të siguronin mbulueshmëri të të gjithë territorit dhe që do ti plotësonin nevojat e Kosovës dhe popullatës së saj. Pa një marrëveshje të tillë z. Hoti vlerësoi se Kosova nuk mund të ecë përpara në procesin e digjitalizimit, që është në interes jo-vetëm të Kosovës por edhe rajonit. Marrëveshja eventuale dhe plani frekuencor që do të zbatohet në Kosovë duhet të përpilohet në bazë të parimeve të njejta me ato që janë përdorur për ndarjen frekuencore të përcaktuar në Gjenevë 06. Në këtë drejtim, sipas z. Hoti duhet të angazhohet edhe Qeveria e Kosovës.

Duke reflektuar mbi procesin e digjitalizimit, z. Hoti bëri thirrje që KPM-ja të jep maksimumin e saj në përgaditjen e rrethanave për zbatimin e digjitalizimit në Kosovë dhe se duhet të merren parasysh përvojat nga vendet e tjera në këtë proces, ashtu që të evitohen problemet eventuale. Ai tha se kujdes i veçantë duhet ti ipet mediave lokale, ashtu që procesi i digjitalizimit të mos çojë drejt zhbërjes së transmetuesve lokal, siç ka qenë rasti në Gjermani, ku për shkak të qasjes së shpejtë në zbatim, kostos së lartë në ndërrimin e teknologjisë dhe provizioneve ligjore shumë kanale lokale janë zhdukur nga spektri i transmetimeve.

Në këtë seance u diskutua edhe mbi nevojën e pjesëmarrjes së audiencës (shiquesve) në procesin e digjitalizimit dhe në përcaktimin e strategjisë në bazë të parimeve të plotësimit të kërkesave dhe nevojave të tyre.

Nga transmetimi analog në digjital – Perspektiva e përbashkët e Bashkimit Evropian

Përvojat Evropiane në procesin e digjitalizimit u paraqitën nga zëvendës kryetari i bordit të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullative (EPRA), z. Damir Hajduk (poashtu përfaqësues i Autoritetit Rregullativ nga Kroacia), si dhe z. Andreë Dumbreck nga Digital TV Group (DTG), ish zyrtar i Autoritetit Rregullativ nga Mbretëria e Bashkuar (OFCOM).

z. Hajduk filloi prezentimin e tij me një pasqyrë të shkurtë të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullative (EPRA), ku edhe Kosova është anëtare fuqiptotë. EPRA është një trup informal, i cili ofron një forum për diskutime joformale, shkëmbim të këndvështrimeve ndërmjet autoriteteve rregullative, shkëmbim të informatave mbi çështjet e përbashkëta të ndërlidhura më rregullativat kombëtare dhe Evropiane dhe diskutime të zgjidhjeve praktike për problemet ligjore që lindin nga interpretimi dhe zbatimi i rregullativave transmetuese. Ajo ka 53 autoritete rregullative si anëtare të rregullta, si dhe Komisionin Evropian, Këshillim e Evropës, Përfaqësuesin për Liri të Mediave të OSBE-së si dhe Observatorin Audiovizuel Evropian, të trija si anëtare të përhershme observuese. EPRA nuk luan rolin e një trupi formal rregulltor, por vetëm ofron një platform të hapur për diskutime mbi një numër të madh çështjesh relevante për rregullatorët.

Pas prezentimit të punës së EPRA-s, z. Hajduk fokusoï prezentimin e tij mbi çështjet kryesore që duhen adresuar gjatë procesit të digjitalizimit. Së pari ai u fokusua në çështjen e kornizës ligjore për digjitalizim, ku dilema që shtrohet është se a duhet ndarë aspektin e transmetimeve nga çështjet programore (të përmbajtjes mediale). Poashtu, si çështje tjetër ligjore z. Hajduk përmendi edhe vendimin mbi formën e licensimit dhe atë në dy nivele, e para – a duhet licensuar operatorët e rrejetave transmetuese ndaras apo së bashku me multiplekset, dhe e dyta a duhet licensuar ndaras secilin transmetues ëe transmeton në vend. Poashtu, e ndërlidhur me licensimin e transmetuesve (mediave), a duhet vazhduar automatikisht licensat për transmetim edhe në rastin e kalimit në transmetim digjital, apo licensat ekzistuese duhet të anulohen dhe të lëshohen ato të rejat. Në transmetime analoge, transmetuesi ka qenë edhe bartësi (shfrytëzuesi ekskluziv) i frekuencës, derisa tani kemi një ndarje në mes të loperatorit dhe ofruesit të përmbajtjes dhe si pasojë qasja ndaj licensimit duhet të ndryshojë. Përvojat me licensimin e rrejetave dhe multiplekseve së bashku apo ndaras poashtu u diskutuan nga z. Hajduk, ku u paraqitën përvoja krejtësisht të ndryshme, ku në njërin anë ka vende ku multipleksi licensohet e pastaj ai zgjedh ofertën programore, derisa në anën tjetër kemi rastet ku transmetuesit individual licensohen. Së dyti, z., Hajduk shtroi çështjen e transmetimit simultan analog dhe digjital (simulcast) me këshillën që periudha e silumkastit është e kushtueshme dhe mundësisht duhet mbajtur sa më shkurtë. Çështja e transmetuesit publik u ngrit si një çështje që duhet rregulluar përmes procesit të digjitalizimit. Pika e fundit e ngritur nga aspekti rregullativ ishte qasja e rregullt e mediave në multiplekse. Edhe në rastet kur licensohen multiplekset, ato në shumë vende kanë të vendosura një sërë kriteresh sikurse janë intresi publik dhe pluralizmi mediatik. Qasja në multiplekse në shumë vende rregullohet me procedurë tenderimi (oferta më e mirë), në disa vende të tjera përmes aukcionit (licitimit) apo edhe në bazë të vendimit politik. Për sa i përket qasjes në multiplekse, sfidë të veçantë paraqesin kërkesat e kanaleve të huaja për përfshirje në multiplekse, ku praktikrat tregojnë se ka vende që në asnjë mënyrë kanali i huaj nuk mund të transmetohet i pakoduar në multiplex-a të transmetimeve digjitale, deri sa në anën tjetër, ka të tillë që e liberalizojnë tregun plotësisht edhe për kanalet e huaja. Si dy dilemat e fundit, z. Hajduk përmendi çështjen e qëndrueshmërisë biznesore dhe fizibilitetit financiar për investime në bazë të strategjisë së digjitalizimit. Së fundit, ai u fokusua në çështjen e përzgjedhjes së teknologjisë në bazë të stadiit zhvillimor/depërtimit të konkurrencës në treg. Si gjërat kryesore në këtë agjendë janë vendosja e shkallës së kompresimit (MPEG2 apo MPEG4), përzgjedhja e sistemit të transmetimit në mes të DVB-T dhe DVB-T2. Së fundi duhet menduar se a do të lejohen mundësitë për transmetime në Definicionin e Lartë (HD) apo edhe dnoshta në të ardhmen edhe në 3D. Përfundimisht, z. Hajduk foli mbi nevojën që

procesi të jetë sa më transparent dhe gjithëpërfshirës, ndërsa fundi i projektit duhet të caktohet në një datë reale. Si përfundim, z. Hajduk tha se korniza ligjore për digjitalizimin duhet ti përshtatet terrenit dhe tregut. Strategjia e kalimit në transmetime digjitale duhet të jetë e menduar mirë dhe në detaj, një proces transparent dhe i parashikueshëm, bashkëpunimi me lojtarët relevant dhe koordinimi me vendet e rajonit.

Mbi përvojën nga procesi i digjitalizimit nga Mbretëria e Bashkuar foli z. Andreë Dumbreck, ish-ekspert nga autoriteti rregullativ i telekomunikimeve OFCOM, tani ekspert në Grupit për TV Digjitale (DTG), një platformë e autoriteteve rregullative, prodhuesve të pajisjeve dhe transmetuesve që merret me përcaktimin e standardeve transmetuese dhe bartjen e njohurive nga proceset e digjitalizimit në vendet e ndryshme. z. Dumbreck fillimisht foli për përvojën nga Mbretëria e Bashkuar duke thënë se në të gjithë botën ende ekziston një kërkesë e madhe për shikim të programeve televizive tokësore dhe ate me sistem të qasjes së pa kushtëzuar. Duke folur nga përvoja Britanike, ai tha se tregu i transmetimeve tokësore digjitale është një treg mjaft inovativ, të cilit duhet dhënë hapsira për zhvillim. Ai tha se kalimi gradual në transmetime digjitale është i mirëpritur dhe se mund të provohen projekte pilot në lokacione specifike për të testuar kalimin. Vetë procesi i kalimit nga transmetimi analog në ate digjital preferohet të bëhet në faza nëpër regjione të caktuara. Një proces i tillë sipas z. Dumbreck nënkupton një fushatë informuese të gjërë, përkrahje për shikuesit të cilët kanë vështirësi në përdorimin e teknologjive të reja, si dhe përkrahjen direkte për shikuesit, ku të gjitha këto aktivitete përkrahëse duhet të financohen nga qeveria.

Sipas z. Dumbreck, për të pasur një proces të suksesshëm të digjitalizimit duhet që të kemi një varg gjërash të realizuara. Së pari, politikrat e qarta qeveritare dhe korniza e përshtatshme rregullative janë shumë të rëndësishme. Qëllimet dhe përgjegjësitë në këtë proces duhet të jenë të qarta. Në këtë proces duhet të ket një lidhësi të qartë dhe një menaxhim të mirë të procesit. Përcaktimi qysh në fillim mbi afatet kohore dhe teknologjitë poashtu lehtësojnë shumë procesin. Në këtë proces duhet të ketë edhe dialog të vazhdueshëm me industrinë dhe palët me interes që nga fillimi, përfshi këtu mediat, prodhuesit/shitësit e pajisjeve dhe të gjithë akterët e tjerë.

Politikrat qeveritare, sipas z. Dumbreck duhet të japin përgjigje në çështjet në vijim. Trajtimi i shërbimit të transmetuesit publik dhe objektivat e tij. Kërkesat ligjore për qasje më të lehtë, që mund të përfshijnë titrat, pozicioni i kanaleve (transmetuesve) në listën e kanaleve (prominenca e kanaleve), gjuha e transmetimeve, shërbimet tekstuale, etj. Më tutje, këto politika duhet të japin përgjigje në ate se çka do të ndodh me brezin frekuencor të liruar dhe se a ka dhe si do të shfrytëzohet dividenda digjitale. Këto politika poashtu duhet të caktojnë edhe kërkesat minimale për mbulueshmëri territoriale dhe të shikuesve, proceset e përzgjedhjes së operatorëve të rrjetave/multiplekseve, çka do të ndodh me televizionet lokale dhe rajonale, përcaktimin e çmimeve për shërbime dhe kërkesat potenciale për ofrim të qasjes në multiplekse për transmetues specifik, sistemet e përkrahjes teknike për shikuesit, si dhe strukturën e financimit të procesit të tranzicionit.

Për sa i përket beneficioneve nga transmetimi digjital për programet televizive, z. Dumbreck shpjegoi se tani një ,multipleks i vetëm mund të mbajë një numër të madh të programeve duke shfrytëzuar vetëm një frekuencë, për shkak se signali digjital kërkon më pak integritet të sinjalit në krahasim me

transmetimin analog, ashtu që frekuencat e vetme mund të përdoren më intensivisht dhe në këtë mënyrë të lirohet një numër i madh i frekuencave për përdorim tjetër.

Në përfundim, z. Dumbreck foli edhe për standardizimin në teknologjinë e transmetimeve digjitale duke paraitur përvojën e Mbretërisë së Bashkuar dhe punën e Grupit për TV Digjitale (DTG). Ai u fokusua në skemat e modulimit të sinjalit duke diskutuar dilemat rreth përzgjedhjes së teknologjisë DVB-T apo DVB-T2. Teknologjia DVB-T është teknologji më e vjetër, e cila është adoptuar nga disa vende që kanë hyrë në procesin e digjitalizimit më herët. Edhe pse për momentin pajisjet pranuese të sinjalit DVB-T janë më të lira, është shumë e mundur që vendet që kanë zgjedhur këtë teknologji të kenë nevojë për edhe një tranzicion në teknologjinë më të re DVB-T2. DVB-T2 si teknologji e zhvilluar dhe e nxjerrë në treg në vitin 2009 ofron shfrytëzim me eficient të spektrit frekuencor, teknologji më të avancuar që mund të përdoret për kontroll kualiteti, kompatibiliteti me shërbime të reja si dhe një eجتëgjatësi më të madhe të sistemit. Këshilla e z. Dumbreck është që të adoptohet teknologjia DVB-T2, si një teknologji tanimë e maturuar, e përdorur nga 28 vende të ndryshme në botë, me një treg të etabluar për pajisje pranuese dhe head-end-a dhe me një çmim vazhdimisht në rënie.

Ne pyetjen se si janë trajtuar transmetuesit tradicional (ekzistues) në Mbretërinë e Bashkuar, z. Dumbreck tha se transmetuesve kombëtar të licensuar në sistemin analog i janë ofruar automatikisht licensa digjitale (përfshi mundësinë për krijimin e rrjetit transmetues), mirëpo të kushtëzuara me specifikacione rreth mbulueshmërisë minimale gjeografike dhe të popullatës që duhet ta arrijnë këta transmetues me sistemin e transmetimeve digjitale. Ndërsa në pyetjen se si mund të ndikojë transmetimi digjital në platofrmat e tjera si ato satelitore dhe kabllore, z. Dumbreck tha se përkundër ofertës shumë të mirë programore digjitale pa pagesë, mbi 50% e shëtpive në Britani kanë vullnet që të paguajë për pakot me qasje të kushtëzuar me pagesë. Nga kjo përvojë, z. Dumbreck shprehu mendimin e tij se transmetimet digjitale tokësore vetëm se mund t'ju ndihmojnë platformave me pagesë. z. Hajduk në anën tjetër shpjegoi se në kroaci transmetuesi publik nuk ka nevojë për licensë, derisa kanalet private kanë marrë licensa automatikisht valide për transmetime digjitale. z. Hajduk në anën tjetër përmendi edhe sfidën me kanalet lokale të cilat tani kalojnë në transmetues regional dhe me këtë ju hyp edhe kostoja, ku numri i tyre sot në Kroaci është më i ulët në krahasim me periudhën para se të fillon digjitalizimi, pikërisht për shkak të këtyre kostove shtesë.

Nga tranmetimi analog në ate digjital – Përvojat rajonale

Konferenca vazhdoi me prezentimin dhe diskutime rreth përvojave rajonale nga procesi i digjitalizimit, ku prezentuan përfaqësuesit e autoriteteve rregullative nga 6 vende të ndryshme të rajonit: Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Sllovenia, Maqedonia dhe Turqia.

Shqipëria

Përvojën e Shqipërisë në procesin e digjitalizimit e prezantoi z. Pirro Braco nga Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit (KKRT). Ai fillimisht përshkroi procesin e digjitalizimit në vitet e fundit në Shqipëri dhe pastaj u ndal në disa nga dilemat dhe sfidat në këtë proces. Si hap i parë në këtë proces, z. Braco përmendi tentimet për sensibilizim të opinionit mbi procesin përmes organizimit të konferencave lokale, regjionale dhe nacionale, të cilat i cilësoi si mjaft të rëndësishme. Komentet dhe vërrejtjet nga këto takime janë marrë për bazë në hartimin e strategjisë së digjitalizimit.

Në procesin e hartimit të strategjisë së digjitalizimit, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë formoi një komitet ad-hoc të nivelit të lartë i cili u udhëheq nga z. Genc Pollo Ministër për Inovacion dhe Teknologji. Ky komitet politik pastaj krijoi sekretariatit ku ishin të përfaqësuar KKRT, Autoriteti Rregullativ i telekomunikimeve, Ministria e Financave, etj. Sekretariati, si nivel teknik, kishte për detyrë hartimin e draft strategjisë dhe në prill të vitit 2010 sekretariati i dërgoi komitetit ad-hoc draft strategjinë për aprovim. Strategjia reflektonte mbi koston e kalimit në transmetime digjitale, investimet në rifreskimin e rrjetit dhe qasjen e propozuar për subvencionimin e dekodereve. Komiteti ad-hoc e paranoi këtë draft strategji në muajin maj 2012, që pastaj kaloi për aprovim nga Këshilli i Ministrave i Qeverisë së Shqipërisë ku edhe u miratua. z. Braco theksoi se fillimisht ishte menduar se procesi do të shkonte shumë shpejtë, mirëpo një proces i tillë merr kohë, gjë që duhet oasur parasysh gjatë caktimit të afateve kohore për kalim të plotë në transmetime digjitale. Afati i caktuar tani për kalim të plotë është 17 qershori i vitit 2015.

Sipas z. Braco, objektivat e procesit të digjitalizimit në Shqipëri janë që të bëhet digjitalizimi i rrjetit analog tokësor dhe në këtë mënyrë të lirohen kapacitetet në spektrin e frekuencave për përdorim alternative, pastaj të ofrohen kapacitete shtesë transmetuese, dhe përfundimisht të mundësohet futaje e teknologjive të reja si shërbimet interaktive dhe ato mobile. z. Braco vazhdoi pastaj me prezantimin e objektivave imediate të këtij procesi që përfshijnë digjitalizimin e rrjeteve analoge të transmetuesit publik, transmetuesve kombëtar privat/komercial, si dhe digjitalizimi i rrjeteve analoge të operatorëve lokal. Si kriter kryesor në këtë proces është marrë niveli i mbulueshmërisë me sinjal, ku është caktuar se sistemi i ri duhet që së paku të ketë nivelin e njëjtë të mbulueshmërisë sikurse rrjetet analoge, kështu që niveli i mbulueshmërisë i përcaktuar duhet të jetë minimum 85% e popullsisë dhe 75% e territorit. Plani në Shqipëri është për transmetime digjitale në 7 + 1 shtresa (mbulime), ku operatori publik do të operonte 2 rrjete, operatorët komercial do të operonin 3 rrjete (ashtu që të gjithë aketrët e tanishëm të kenë mundësinë e vazhimit të veprimtarisë), operatorët regjional 2 mbulime, dhe përfundimisht operatorët lokal me 1 rrjet ku do të mbulonin 11 lokalitete.

z. Braco theksoi se problemi kyç është të arrihet kalimi në transmetime digjitale pa probleme. Për këtë qëllim është analizuar edhe gjendja e operatorëve aktual të transmetimeve analoge si dhe digjitale në Shqipëri. Duke marrë parasysh faktin se operatorët e nivelit lokal nuk kanë mundësi të mjaftueshme financiare për të mbuluar ndërtimin e rrjeteve të tyre, është vendosur që të jipet në shfrytëzim njëri rrjet i operatorit publik për nevojat e operatorëve lokal, ashtu që këta të mund të vazhdojnë së ekzistuari. Secili rrjet lokal (duke përdorur rrjetin e dytë publik) do të ketë nga një head-end të vetin.

Strategjia poashtu përcakton edhe teknologjinë, ashtu që të gjithë operatorët do të përdorin sistemin DVB-T2 me kompresion MPEG4.

Strategjia poashtu përcakton një nivel të mbështetjes së operatorëve, ku çmimet e transmetimeve do të dallojnë varësisht nga zona dhe koncentrimi i shikuesve. Kjo mbështetje sipas z. Braco konsiston në atë se do të përdoren çmime të kontrolluara e jo ato të tregut. Çmimet e kontrolluara si dhe lehtësimet e tjera do të duhej të mundësojnë një kalim më të lehtë.

Për sa i përket qasjes ndaj procesit, z. Braco tha se në Shqipëri do të përdoret parimi i ishujve digjital, që do të thotë se rrjeti digjital do të ndërtohet në një alotment specifik ku pastaj aty do të mbështeten operatorët e tjerë, gjë që mundëson që edhe periudha e simulcastit të menaxhohet me kosto më të përballueshme.

Për sa i përket parimeve të licensimit të operatorëve, është zgjedhur qasja e licensimit të platformës (multipleksit) dhe programit në të njëjtën kohë. Mirëpo, ky opcion nuk do të lejojë përdorimin e kapacitetit të plotë të frekuencës përkatëse nga operatori i multipleksit, mirëpo do ta kufizojë atë në përdorimin e 60% të kapacitetit, derisa 40% e kapacitetit do tu ofrohet të tjerëve për licensin në faza të mëvonshme.

Një problem në procesin e Shqipërisë është se Strategjia u miratua para ligjit për digjitalizim dhe tani duhet të përshtatet. Fillimisht sistemi DVB-T ishte rekomanduar në draftin e parë të strategjisë, mirëpo duke marr parasysh përparësitë teknologjike të sistemit DVB-T2 dhe uljen e çmimeve të pajisjeve për këtë sistem, sistemi DVB-T2 është rekomanduar në ligjin e ri, gjë që z. Braco rekomandon edhe për Kosovën.

Një karakteristikë e tregut të Shqipërisë është se ekzistojnë operatorë digjital që aktualisht funksionojnë pa licensë dhe përdorin sistemin DVB-T. Sipas z. Braco, procesi i kalimit në transmetime digjitale sipas ligjit të ri do të shkaktojë një kosto të konsiderueshme për këta operatorë që të kalojnë në sistemin e ri DVB-T2. Prandaj është vendosur që këtyre operatorëve tu ofrohet një periudhë tranzicioni prej 2-3 vitesh ashtu që ky proces të jetë i përballueshëm për ta.

Për sa i përket çështjes së subvencionimit të dekoderëve, strategjia fillimisht ka paraparë që të gjithë dekoderët të subvencionohen 100%, mirëpo një gjë e tillë nuk është miratuar dhe vetëm 7% të familjeve Shqiptare do të përfitojnë nga subvencionimi. Ky subvencion pjesërisht do të financohet nga buxheti e pjesërisht nga pagesat që operatorët bëjnë për licensim.

Plani i veprimit në Shqipëri është që në tetor të vitit 2012 të fillojë implementimi në regionin e Tiranës dhe pastaj të shkohet me parimin e ishujve digjital. Në ndërkohë duhet të aprovohet ligji për digjitalizim ashtu që ky proces të mund të fillojë në orarin e paraparë.

Gjatë diskutimit u shtruan edhe pyetje rreth mënyra për licensimin, ku z. Braco përmendi disa mënyra të licensimit të multipleks operatorit veçmas nga programet specifike që do të licensoheshin një nga një, mirëpo agrumentoi zgjidhjen e bërë në Shqipëri, ku operatori i multipleksit licensohet së bashku me 60% të programacionit në multipleks, ndërsa 40% licensohen ndaras, ashtu që të sigurohet pluraliteti medial,

ku lista e programeve përcaktohet nga autoriteti rregullator në bashkëpunim me publikun. Ne pyetjen se a ka nevojë që operatori publik të licensohet nga autoritetit rregullator dhe se a mund ti merret licenca, z. Braco tregoi se autoritetit rregullator nuk licenson transmetuesin publik por që këtë e bën parlamenti dhe menaxhohet nga një Bord i caktuar nga Qeveria apo nga Parlamenti

Kroacia

Përvojat nga procesi i digjitalizimit në Kroaci u paraqitën nga z. Damir Hajduk, anëtar i Këshillit për media Elektronike pranë Agjencionit për Media Elektronike. Si tregoi se strategjia kroate për digjitalizim u aprovua nga qeveria Kroate në vitin 2008, derisa ligji i ri që rregullon këtë kalim është aprovuar në vitin 2010. Ky proces sipas z. Hajduk është plotësuar nga një numër i madh debatesh dhe përfshirja e këndvështrimit të palëve të ndryshme me interes. Transmetimet në Kroaci janë të rregulluara përmes Ligjit për Media Elektronike, Ligjit për Ration Televizionin Kroat (shërbimi publik), si dhe Ligji mbi Komunikimet Elektronike (i cili mbulon aspektet teknike dhe operacionale). Ligji mbi Mediat Elektronike përcakton Këshillin si trupi që do të bart procesin në Kroaci.

Përzgjedhja teknologjike në procesin e digjitalizimit në Kroaci është bazuar në interesin publik, duke ofruar shërbime si mbrojtja e të miturve nga programet jo të përshtatshme, si dhe duke ofruar informim të përgjithshëm për shikuesit.

z. Hajduk pastaj foli mbi funksionimin e sistemit të transmetimeve digjitale në Kroaci. Ai that se Ai sqaroi se hapsira në multiplekset aktive alokohet përmes procesit të tenderimit. Vetë procesi i mëvonshëm i licensimit është më i komplikuar dhe transmetuesit në Kroaci janë edhe më fuqishëm të rregulluara në krahasim me psh operatorët e internetit (ISP), gjë që sipas z. Hajduk nuk është në rregull pasi sipas tij kushtet duhet të jenë të ngjajshme.

Ai pastaj vazhdoi me prezentimin e sfidave kryesore ligjore në këtë proces ku bëjnë pjesë edhe saktësia dhe përmbajtja e programacionit, pozicionimi i transmetuesve në listën e kanaleve duke marr parasysh preferencat e zakonshme janë që numri i kanalit të jetë në top 10, si dhe kërkesat specifike për transmetuesit lokal të cilët tani detyrimisht bëhen transmetues regional dhe me këtë rritet mbulueshmëria territoriale dhe kërkesat ligjore mbi mbulueshmërinë e këtij territori me lajme dhe përmbajtje regionale që detyrimisht bart kosto më të lartë. Për pozicionim në listë të kanaleve, ekzistojnë disa kritere që përdoren në Kroaci: Niveli i Koncesionit, numri i banorve në atë zonë, vite pune në Kroaci, si dhe kuotata të prodhimit programor. Për transmetuesit lokal dhe regional, kalimi në transmetime digjitale paraqet edhe nje sfidë shtesë, atë të kostove për ngarkesën e koncesionit (i kalkuluar në bazë të numrit të banorëve në zonën përkatëse).

Procesi në Kroaci është kryer në faza nëpër nëntë regjione digjitale, ku kalimi në transmetim digjital është bërë hap pas hapi në secilin regjion. Ekipet e vullnetarëve janë angazhuar në këtë proces, ku ata kanë dhënë përkrahje për personat me aftësi të kufizuara, shikuesit që kanë pasur probleme me përdorimin e teknologjisë, si dhe kanë shpërndarë kupona për digjitalizim.

Sot në Kroaci funksionojnë 3 multiplekse pa poagesë: A, B dhe D. Multipleksi A ofron një mbulueshmëri kombëtare prej gati 100%; Multipleksi B është i fokusuar në programe zbatimëse, ndërsa multipleksi D

bart kanale komerciale dhe kombëtare. 2 multiplekse të tjera (C dhe E) janë Platforma e planifikuar me pagesë. Pritjet janë se deri në shtator 2012 të fillojnë edhe transmetimet në HD. Platforma e përzgjedhur është platformë hibride STB dhe me standard përpunimi të të sinjalit në MPEG 4 – T2. Një ndarje e tregut na tregon se tregu dominohet nga transmetimet tokësore (60.74%), ndërsa si pjesëmarrës i dytë në treg është IPTV me 23.75% të tregut.

Një sfidë që del nga procesi i digjitalizimit është edhe numri më i madh i prograve televizive që transmetohen në vend, derisa buxhetet për reklamim të entiteteve të ndryshme nuk rriten, gjë që e bën problematike qëndrueshmërinë financiare të transmetuesve televiziv. Kjo sidomos është ndjerë në Kroaci gjatë periudhës së fundit të recesionit, sidomos nga transmetuesit lokal.

Si përfundim, z. Hajduk konkludoi se procesi i kalimit në transmetim digjital është kompleks. Licensimi i operatorëve të transmetimit digjital tokësor duhet të jetë më pak kufizues, ngajshëm me licensimin për internet. Sipas z. Hajduk, është shumë me rëndësi të ruhet pluralizmi medial në vend. Harmonizimi me vendet fqinje është shumë i rëndësishëm, dhe këto z. Hajduk përmendi problemet që Kroacia ka me shtetin fqinj të Italisë si pasojë e mospërbajtjes nga Italia të ndarjes frekuencore nga Gjeneva 06, gjë që ndikon edhe në transmetimet televizive edhe në ato në radio. Përfundimisht, autoriteti rregullatib duhet të merr parasysh edhe trendet e tregut dhe të analizojsë se çka dëshirojnë shikuesit, dmth interesimin e shikuesve për shërbime më të avancuara si transmetimet në HD, 3D si dhe shërbimet e paguara televizive.

Mali i Zi

Përvojën e Malit të Zi e pezantoi znj. Jadranka Filipovic-Vojvodic nga Agjencioni për Mediat Elektronike të Malit të Zi. Ajo tregoi se për momentin në Malin e Zi nuk ekzistojnë transmetimet digjitale dhe se penetrimi i platformave të tjera është dominant, ndërsa shkalla e penetrimit të platformave të ndryshme varet nga regjioni i malit të zi. Nga platformat ekzistuese, momentalisht transmetimet analoge kanë një shkallë penetrimi prej 37%, IPTV 27%, DTH (Direct to Home – satelitore) 18%, MMDS (Multichannel Multipurpose Distribution Service) 10% dhe kabllorët 8%. Dominimi i platformave të reja është më i madh në pjesët bregdetare të Malit të Zi, derisa platforma tokësore analoge mbizotëron në pjesën veriore të vendit.

Transmetimet dhe procesi i digjitalizimit në Malin e Zi rregullohen përmes 5 ligjeve: Ligji për media, Ligji për transmetime digjitale, Ligji për mediat elektronike, Ligji për komunikime elektronike dhe Ligji për transmetuesin publik. Z. Filipovic-Vojvodic tregoi se Strategjia për digjitalizim është hartuar në Malin e Zi dhe është aprovuar nga autoriteti rregullativ, miëpo kjo strategji nuk është aprovuar ende nga Parlamenti. Nga aspekti institucional, në Malin e Zi ekzistojnë katër shtylla kryesore: Agjencia për Media Elektronike, Agjencia për Komunikime Elektronike dhe Postë, Ministria e Kulturës, dhe Ministria e Shoqërisë Informativë dhe Telekomunikimeve.

Znj. Filipovic-Vojvodic teksoi se përkundër vërshtirësive në përpilimin e strategjisë, Agjencioni për Media Elektronike me ndihmën e misionit të OSBE-së ka hartuar vetë strategjinë e digjitalizimit, ku edhe janë përcaktuar një varg objektivash. Si pika kyçe të përbajtjes së strategjisë, znj. Filipovic-Vojvodic tha

se duhet të jenë ndër të tjera analiza e situatës aktuale, identifikimi i çështjeve rregullatore dhe teknike, përcaktimi i objektivave, plani i veprimit për kalim, afatet kohore dhe konsideratat ekonomike, përcaktimi i indikatorëve të suksesit dhe dividenda digjitale. Në fakt, sipas znj. Filipovic-Vojvodic, i gjithë procesi i digjitalizimit të transmetimeve tokësore në fundamentin e tij ka për qëllim dividendën digjitale përmes lirimit të spektrit frekuencor për zhvillimin e platformave dhe produktetve e shërbimeve të reja.

Procesi i digjitalizimit në Mal të Zi është paraparë të zgjasë 4 vite si një kornizë kohore. Objektivat që dalin nga strategjia përfshijnë vendimin që të gjithë transmetuesit publik të kenë qasje në distribuimin e kontentit përmes platformës pa pagesë, derisa përmbajtjet e tjera programore do të ofrohen përmes platformave me pagesë. Strategjia përcakton edhe shkallën e mbulueshmërisë, ku për shkak të konfiguracionit gjeografik, ky synim shëndërrohet në arritjen e një shkalle të mirë të mbulueshmërisë ose përmes transmetimeve tokësore ose përmes satelitit. Poashtu, në kuadër të strategjisë janë paraparë edhe angazhimi në përkrahjen e grupeve dhe personave me vështirëse.

Disa nga udhëzimet e ofruara nga znj. Filipovic-Vojvodic janë se, fillimisht duhet identifikuar të gjitha palët me interes dhe me ta të dikutohet kostoja e kalimit. Procesi i kalimit duhet shpejtuar ashtu që hapsira për simulcast duhet të zvogëlohet. Licensat për operatorët ekzistues duhet reviduar apo ridefinuar. Përfundimisht, sipas znj. Filipovic-Vojvodic, duhet identifikuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara apo me pamundësi për të përcjellë procesin. Është shumë e rëndësishme që pajisjet dhe teknologjia të definohen sa më herët si dhe të definohet ndarja e të hyrave nga këto mjete. Poashtu duhet konsideruar krijimin e një fondi special publik me qëllim të subvencionimit të pajisjeve dhe për nevojat e një fushate informative. Znj. Filipovic-Vojvodic theksoi se në këtë proces Malin e Zi e ka ndihmuar edhe Komisioni Evropian

Sa i përket çështjes së licensimit, operatorët publik nuk hyjnë në tender dhe vetëm duhet të kërkojnë lejen. Kanalet e tjera komerciale që kanë ekzistuar më parë duhet të kalojnë nëpër procedurë tenderi.

Znj. Filipovic-Vojvodic theksoi edhe mësimet e marra gjatë procesit të digjitalizimit në vendin e saj. Kështu që, përkushtimi i nivelit politik është shumë i rëndësishëm, hartimi i një plani kohor për secilin regjion, komunikimi me palët e tjera me interes duhet të jetë transparent. Poashtu, sipas saj, duhet zhvilluar modele për vlerësimin e kostove, me një preferencë për free-to-air. Roli i qeverisë fillimisht është neutral dhe duhet të mbahet i limituar. Përfundimisht strukturat koordinuese të procesit duhet të definohen me ligj dhe duhet punuar në drejtimin e aprovimit të ligjeve relevante duke përdorur qasjet nga vendet e rajonit.

Slovenia

Përvojën nga Slovenia, si një vend që ka kaluar nëpër procesin e digjitalizimit, e prezantoi z. Igor Funa nga Agjencioni për Postë dhe Komunikime Elektronike. Ai filloi me prezantimin e pasqyrës së transmetimeve analoge në Sloveni ku kanë ekzistuar 2 programe publike, 3 komerciale dhe 10 kanale regjionale apo lokale. Mbulueshmëria në Sloveni arrihet përmes 230 pikave transmetuese dhe mbulon 98% të popullatës.

z. Funa pastaj prezantoi sfidat kryesore në procesin e digjitalizimit në Slloveni, ku definimi i alotmenteve për SFN (Single Frequency Network) ka qenë sfida kryesore, ku në Slloveni janë ndarë 3 alotmente secila me nga një SFN. Qasja ndaj procesit ka qenë e bazuar në qasjen e barabartë të qytetarëve duke u bazuar në transmetime në 7 mbulime në UHF dhe 1 mbulim në brezin VHF. Plani frekuencor në Slloveni është bazuar në Gjeneva 06 dhe transmetimet janë moduluar në MPEG4 standardin. Sllovenia ka filluar me transmetime të rregullta digjitale në vitin 2006, fillimisht duke përdorur frekuenca të përkohshme, që më vonë sipas z. Funa është treguar si qasje e gabueshme pasi ndërimi i frekuencave gjatë procesit e vështirëson shumë procesin e adoptimit të teknologjisë së re nga shikuesit.

Fillimisht transmetuesit publik i është dhënë e drejta për operimin e një rrjeti kombëtar, mirëpo duke e kufizuar të drejtën për aplikim për rrjetin e dytë. Multipleksi (rrjeti) A në vitin 2007 kishte mbulueshmëri prej 70% dhe në multipleksin A kanë qenë prezente vetëm kanalet publike. Sipas z. Funa, periudha e gjatë e simulkastit (2006-2010) ka shkaktuar problemin që kanalet komerciale nuk kishin intesim për transmetime digjitale për shkak të kostos së lartë të transmetimet në të dy aviantet (analoge dhe digjitale). Kanalet komerciale filluan të kalojnë në transmetime digjitale vetëm pasi shteti vendosi të ofrojë subvencione për transmetime digjitale në vitin 2009.

Në vitin 2007 Sllovenia aprovon Ligjin mbi Transmetime Digjitale, ku definohen edhe specifikacionet e dekoderëve (pranuesve), që në atë kohë përcaktoi kodimin me MPEG4. Me këtë ligj ishte poërcaktuar që data e kalimit të plotë në transmetime digjitale të jetë 1 dhjetori 2010. Qasja e këtillë ka shaktuar shumë probleme. Poashtu, në kohën e aprovimit të ligjit, shumë shitës të paisjeve kishin ende stoqe të shumta të pranuesve (reciever) me kodim MPEG2. Për ta komplikuar problemin edhe më tej, si pasojë e specifikacioneve të gabueshme për paisjet pranuese, disa pranues MPEG4 kishin problem me pëkrahen e zërit në kodimin MPEG4.

Në vitin 2008 Sllovenia shpalli tenderin publik ndërkombëtar për operator të multipleksit B, të cilin e fitoi kompania Norvegjeze Norkring. Mirëpo, për shkak të kostos së lartë të investimeve dhe shpenzimeve të tjera, kostoja në multipleksin B ishte e lartë dhe kanalet komerciale nuk ishin të interesuar për të qenë në këtë platformë, edhe pse ideja fillestare ka qenë që ky multipleks të fokusohet në programe zbavitëse komerciale. z. Funa tha se edhe një vit pas dhënies së licencës për operatorin e dytë, asnjë kanal nuk transmetonte në multipleksin B dhe vetëm pas subvencionimit të shtetit kanalet komerciale filluan të transmetojnë mirëpo tani ata zgjodhën multipleksin A (të operuar nga transmetuesi publik). Në të njëjtën kohë, u shpallën edhe tenderët poërrjetat regjionale/lokale në Slloveni.

Deri në shtator të vitit 2010, Sllovenia kishte arritur të transmetojë 5 kanale kombëtare dhe 5 regjionale në multipleksin A me mbulueshmëri prej 90%, ndërsa 2 kanale kombëtare në multipleksin B (85% mbulesë). Në këtë kohë, Sllovenia filloi edhe me fushatë agresive informative për kalimin në transmetime digjitale duke krijuar edhe një qendër thirrjesh për të informuar dhe këshilluar qytetarët. Në dhjetor 2010, pothuajse të gjithë transmetuesit analog u shuan dhe u kalua në transmetime digjitale. Mirëpo, për shkak të probleme gjatë procesin 4 vjeçar, disa transmetues lokal u larguan nga platformat tokësore plotësisht për shkak të kostos së lartë, derisa multipleksi B shumë shpejt u shua pasi nuk kishte asnjë transmetues në të dhe operatori Norvegjez është duke e lëshuar tregun Slloven. Të gjithë

ransmetuesit kaluan në multipleksin publik A për shkak të kostos më të ulët. Si përfundim, z. Funa tregoi se pas digjitalizimit Sllovenia kishte më pak transmetues sesa gjatë periudhës analoge.

Duke folur për mësimet e përfituara nga ky proces, z. Funa theksoi se ligjet dhe rregulloret nuk mjaftojnë për një proces të suksesshëm. Periudha e gjatë simulkastit është shumë e kushtueshme dhe nuk preferohet. Specifikacionet e pajisjeve për pranimit të sinjalit digjital duhet të jenë shumë të sakta dhe të detajuara për të evituar problemet me pranimit të sinjalit. Afatet kohore të përcaktuara duhet të jenë reale dhe me çdo kusht duhet përmbajtur. Ndryshimi i shpeshtë i frekuencave duhet evituar dhe rrjetat duhet të fillojnë së operuari me parametrat teknik final të përcaktuar. Sipas z. Funa, mbulueshmëria, kanalet dhe pajisjet pranuese nuk mjaftojnë dhe se përvoja e shikuesve është shumë e rëndësishme. Pajisjet digjitale në përgjithësi janë më të komplikuar për tu konfiguruar dhe përdorur. Sinjali digjital ka specifikat që ose kemi fotografi të shkëlqyeshme ose nuk kemi aspak sinjal. Poashtu, pajisjet kanë koston e tyre dhe edhe pajisjet më të lira mund të duken të shtrenjta për shumë qytetarë. Përfundimisht, z. Funa tha se fushata informuese duhet të arrij te secili qytetar.

Maqedonia

Një prezentim i shkurtë mbi përvojën dhe stadin e procesit të digjitalizimit të transmetimeve në Maqedoni është dhënë nga z. Selver Hajdini dhe z. Lazo Petrosevski, anëtarë të Këshillit Radiodifuziv të Republikës së Maqedonisë. Z. Hajdini presentoi rastin e valës së dytë të tranzicionit në transmetime digjitale në Maqedoni, duke kaluar nga sistemi DVB-T në ate DVB-T2. Maqedonia ka qenë një nga vendet e para në regjion që ka futur transmetimin digjital tokësor në vitin 2009, përmes tenderimit të fituar nga operatori privat One (Telekomi Slloven), si dhe përmes rrjetit të veçantë publik të Radiodifuzionit të Republikës së Maqedonisë, dhe si pasojë sistemi i përcaktuar atëhere ishte DVB-T. Tani Maqedonia është para sfidës së kalimit në gjeneratën e ardhshme DVB-T2, gjë që sipas z. Hajdini nuk do të duhej të ishte shumë problematik dhe i kushtueshëm, pasi qysh tani ekzistojnë kompani të cilat kanë ofruar zgjidhje për mbindërtimin e sistemit aktual DVB-T në DVB-T2. Mirëpo, z. Hajdini shprehu brengën rreth çështjes së konvertimit të pajisjeve pranuese, pasi që shikuesit që tanimë kanë blerë pranues DVB-T nuk do të mund të pranojnë sinjalin DVB-T2. Këta shikues sipas z. Hajdini do të duhet të blejnë konvertues shtesë për të mundur të konvertojnë dhe pranojnë sinjalin në DVB-T2.

Koha e caktuar për ndërprerjen e sinjalit analog në maqedoni është data 12 qershor 2013, dhe deri në atë kohë do të duhet të bëhet edhe konvertimi i sinjalit në DVB-T2. Si pjesë e procesit, Qeveria e maqedonisë ka ndarë 10 milion Euro për të vënë në funksion dy multiplekse të rrjetit publik të radio difuzionit maqedonas si dhe 7 milion Euro për servicing publik ku emetohen programe në tre kanale televizive. Qëllimi këtu është që të përmirësohet edhe kualiteti i emetimit dhe të kaluhet në emetim të programeve në High Definition (HD).

Poashtu z. Hajdini njoftoi konferencën se Agjencioni për Komunikime Elektronike ka shpallur tenderin për operatorin për Free to Air me qëllim që të mundësohet televizioneve komerciale që të kenë qasje në tre multiplekse të ndryshme, dy në nivel nacional dhe një në nivel regjional. Deri sa operatorët digjital nuk janë plotësisht të gatshëm për punë, sinjali i televizioneve komerciale do të transmetohet përmes rrjetit publik të Radiodifuzionit të maqedonisë.

Sipas z. Hajdini, sfida kryesore për Radiodifuzionin e Maqedonisë është vetëdijësimi i qytetarëve për procesin e tranzicionit të plotë dhe çkyqjes së sinjalit analog. Sipas të dhënave, nga 15-25% të popullatës në Maqedoni vazhdojnë të shiqojnë programe ne sistemin analog me antena të thejshta. Lidhur me këtë qeveria e Maqedonisë ka siguruar rreth 1 milion Euro për të subvencionuar plotësisht 40,000 paisje pranuese për familjet në asistencë sociale, që sipas z. Hajdini do të duhej zbutur sfidat rreth kalimit ne sistem digjital.

Turqia

Në emër të Këshillit të Lartë për Radio dhe Televizion të Turqisë foli z. Erdem Cakmak. Z. Cakmak prezantoi rolin e këshillit të lartë në Turqi dhe strukturën organizative. Ai njoftoi konferencën së Turqia ka aprovuar ligjin e ri mbi Transmetimet në bazë të konkluzave të dala nga gjeneva 06. Sipas tij, këshilli i Lartë planifikon që tani të punojë në përgaditjen e planit frekuencor për televizion dhe radio përbrenda kornizave të caktuara nga Gjeneva 06. Ai tha se Turqia është përcaktuar për sistemin DVB-T2 dhe kodimin MPEG4.

z. Cakmak pastaj u fokusuan në arsyet e zgjedhjes së DVB-T2 si sitem transmetimi duke i përmendur arsyet për zgjidhjen e tillë. Së pari, kapaciteti më i madh i DVB-T2 luan rol në një vend, sidomos nëse kemi parasysh qëllimin e pluralizmit medial si dhe ekonomitë e shkallës. DVB-T2 mundëson qëndrueshmëri më të madhe si dhe aplikimin e teknikave më të reja të modulimit dhe kodimit. Sipas z. Cakmak, në përcaktimin e saj turqia ka pasur parasysh edhe parimin e përdorimit eficient të spektrit frekuencor. Një tjetër konsideratë e përmendur është fleksibiliteti i kësaj teknologjie, e cila lejon kombinime të ndryshme. Përfundimisht, mundësia për të krijuar SFN (single frequency networks) në zona të mëdha ka qenë edhe një arsye shtesë për përcaktimin për DVB-T2.

Në planifikimin frekuencor, z. Cakmak prezantoi edhe statet e përcjellura nga autoriteti rregullativ. Së pari është bërë përcaktimi i pikave transmetuese dhe janë kryer matjet në terren. Më pas është bërë analiza e mbulueshmërisë dhe interferencave potenciale. Në bazë të këtyre matjeve, autoriteti ka bërë përcaktimin e frekuencave për pikat specifike tranmetuese. Një konsideratë e posaçshme, sipas z. Cakmak, i është dhënë edhe koordinimit ndërkombëtar, sidomos në zonat kufitare.

z. Cakmak pastaj prezantoi edhe natyrën e menaxhimit të procesit, i cili në Turqi është ndarë në të ashtuquajturat Paketa Punuese PP (Eörking Packages) dhe ate në katër sosh: Menaxhimi i Projektit, Analiza teknike, planifikimi dhe raportimi, Testimi dhe verifikimi, si dhe Trajnimi. Z. Cakmak u fokusua në Paketën Punuese 2, analizën teknike, planifikimin dhe raportimin, ku përshkroi aktivitetet konkrete në kuadër të këtij grupi, siç janë Studimi i planit nga Gjeneva 06 dhe akteve finale, analiza e teknologjive transmetuese tokësore, përgaditja e planit kombëtar frekuencor, përcaktimi i multiplekseve kombëtare, regjionale dhe lokale. Si pjesë e punës së këtij grupi punues ishte edhe kalkulimi i tarifave për licensat e transmetimeve tokësire si dhe tarifrat vjetore për kanal dhe përdorim të frekuencës për secilën pikë transmetuese. Ky grup poashtu është i ngarkuar edhe me planifikimin e planit frekuencor për radio si dhe përgaditjen përgaditjen e njoftimeve për ITU-në dhe përgaditjen për zbatimin e planit për kalim në transmetime digjitale. Z. Cakmak foli edhe për kërkesat bazike të një projekti të kësaj natyure, ku hyjnë nevoja për Softuer të specializuar për inxhinjeri të spektrit frekuencor, Sisteme për Menaxhimin e

Databazave, Sistemet e GIS-it dhe Hartat digjitale përfshi informatat si elevacioni, zonat e populluara, kufinj të provincial dhe të qarqeve, rrugët, lumenjtë e liqenet, pendat, etj. Pastaj z. Cakmak paraqiti disa shembuj nga hartat dhe matjet e bëra në Turqi, përfshi të gjitha elementet e analizuara.

Pastaj z. Cakmak paraqiti edhe disa parametra teknik të matjeve të bëra dhe kriteret për planifikim siç janë kanalet potenciale në brezin VHF dhe UHF, llojin e bartjes, intervalin mbrojtës, tipin e modulimit dhe shkallën e kodimit. Au tha se Turqi ka 948 pika transmetuese dhe se nga këto planifikohet të nxirren 779 SFN dhe 7,360 alokime frekuencore. Zonat e mbulimit të SFN-ve u paraqitën në formë grafike për të gjithë territorin e Turqisë si dhe me fokus të veçantë në zona urbane me shembullin e Stambollit.

Në fund z. Cakmak përshkroi edhe llojin e informatave të mbledhura në Databazën për procesin e digjitalizimit, që ndër tjera përfshijnë, numrin e zonës, krahinën, qarkun, lokacionin, elevacionin dhe pikë referimin gjeografik, lartësinë e antenës, këndet e vendosjes, fuqinë rrezatuese efektive, numrin e kanalit, SFN/MFN kodin, numrin e multipleksit, zonën e alotmentit sipas Gjenevës 06 dhe listën e vendeve fqinje për koordinim në radius më të afërt dhe në radius prej 1,000 km. Ai përfundoi duke thënë se plani është që Turqia të kalojë në transmetim digjital nëpër faza në bazë të regjioneve dhe se kalimi i plotë dhe shymbja e sinjalit analog planifikohet për mesin e vitit 2015.

Rregullimi i transmetimit në periudhën e digjitalizimit

Seancat e ditës së dytë të konferencës ishin në formë të panel diskutimeve, ku përfaqësuesit e autoriteteve rregullative të cilët diskutonin mbi temat specifike dhe ky diskutim ishte i hapur edhe për pjesëmarrësit e tjerë të konferencës. Së pari u diskutua aspekti ligjor dhe regjimet e licensimit për transmetim digjital.

Përfaqësuesja nga Mali i Zi foli për ambientin rregullativ duke thënë se ekzistojnë një varg ligjesh si dhe strategjia që ofrojnë bazën për digjitalizim. Derisa në të kaluarën ka qenë një stacion, një frekuencë dhe një licensë, tani me digjitalizim gjërat komplikohen dhe për këtë arsye rolet e palëve të ndryshme duhet të definohen qartë. Sipas saj duhet identifikuar tre subjekte, operatorin e rrjetës, ofruesit e shërbimeve dhe ofruesit e përmbajtjes, dhe të gjitha këto palë duhet të involvohen para se të fillojë digjitalizimi. Praktika në Malin e Zi është se licensat për ofrues të kontentit lëshohen përmes procesit të tenderimit sikurse edhe për operatorët e multiplekseve. Znj. Filipovic-Vojvodic tha se në këto tendere duhet caktuar kriteret e karta, objektive dhe të matshme. Në Malin e Zi, programet publike kombëtare është vendosur që të përfshihen në të gjitha platformat dhe ate pa pagesë, mirëpo një vendin i tillë është debatuar shumë dhe kjo mund të ndryshojë në të ardhmen. Poashtu, ajo theksoi se edhe e drejta për të tërhequr licensën është shumë e rëndësishme dhe se një gjë e tillë duhet të jetë e përshkruar edhe në ligj.

Përvoja nga Shqipëria është se edhe ligjet përkatëse edhe strategjia duhet të jenë të hartuara dhe në harmoni. Ligji mbi kalimin në transmetime digjitale është i bazuar në zgjidhjet e dhëna në strategji dhe në fakt ligji mundëson zbatimin e strategjisë. Z. Braco poashtu theksoi kompleksitetin e transmetimeve digjitale ku tani në një frekuencë mund të mbështeten shumë programe si radio ashtu edhe televizione, kështu që duhet pasur parasysh një qasje tjetër. Platformat e tjera siç janë ajo kabllore dhe satelitore më nuk kërkojnë liçensim në Shqipëri, vetëm nevojitet një autorizim administrativ për të ofruar shërbimin. Plani është që në Shqipëri liçensat për shërbimet e transmetimit tokësor do të ipen përmes garës së hapur. Ligji parasheh dy tipe liçensash, atë për ndërtimin / operimin e një rrjeti transmetues si dhe atë për ofrim të kontentit. Brezi frekuencor është caktuar dhe garës do ti nënshtrohen vetëm operatorët që punojnë në këtë brez.

Përvoja nga Mbretëria e Bashkuar është se ekzistojnë tre komponente të liçensimit, ajo mbi shfrytëzimin e spektrit, liçensat për multiplekse dhe liçensat për kontent.

Në pyetjen se si më lehtë të kalohet nëpërmes tranzicionit, dhe si ka funksionu periudha e simulkastit, përfaqësuesi nga Sllovenia ritheksoi se përvoja në Slloveni është se periudha e tranzicionit ka zgjatur 5 vite dhe se gjatë gjithë kësaj kohe ka pasur simulkast në analog dhe digjital. Fillimisht ransmetimin digjital e kanë filluar programet publike, ndërsa pastaj janë shtuar edhe kanalet komerciale dhe mediat lokale. Në Slloveni në fund të procesit në fakt kishte regresion pasi numri i transmetuesve u zvogëlu në krahasim me periudhën para digjitalizimit.

Rasti i Shqipërisë është i tillë që nga viti 2004 ekzistojnë rrjete digjitale, mirëpo këto rrjete nuk janë të liçensuara. Këto rrjete kanë përdorur frekuenca të cilat nuk i janë alokuar Shqipërisë në konferencën ndërkombëtare, por frekuenca të tjera. Kjo fazë jo-zrytare ka ndihmuar megjithatë në adaptimin e shikuesve me teknologji digjitale. Megjithatë, koha sa më e shkrutë e simulkastit është e preferuar. Sipas strategjisë kalimi do të bëhet përmes principit të ishujve digjitalë, regjion pas regjioni. I gjithë procesi në Shqipëri pritet të zgjasë rreth 3 vite, ku mesatarisht do të shpenzohen 5 muaj për kalimin në secilin regjion. Turqia në anën tjetër planifikon të tenderojë për operatorët e rrjetave dhe multiplekseve, ndërsa transmetimi në simulkast pritet të zgjasë deri në dy vite. Në anën tjetër, në Britani procesi i i simulkastit ka qenë i gjatë pasi që nuk është arritur mbulesa e kërkuar për një kohë.

Planifikimi frekuencor dhe planet inxhinjrike janë shumë të rëndësishme, mirëpo edhe ndikimi ekonomik duhet të merret parasysh. Rasti i Shqipërisë është se transmetuesit nalog kanë vazhduar transmetimet në frekuenca të njejta derisa ato digjitale emetojnë në frekuencat e alokuara në Gjeneva 06. Edhe përfaqësuesi kroat tha se periudha e gjatë dhe e kushtueshme e simulkastit. Kalimi në digjital gjatë periudhë se siëtchover shkon me periudha dhe për kalim duhet që njerëzit të motivohen përmes ndoshta kanaleve të reja. Poashtu simlukasti sipas z. Hajduk nuk është në interes të transmetuesve të cilët dëshirojnë ta kenë sa më të shkurtë këtë periudhë.

Probleme të tjera në proces që u përmendën janë se zonat rurale janë të fundit që mbulohen me sinjal digjital. Në anën tjetër Mbretëria e Bashkuar ka përdorur një qasje tjetër, ku qytetet e mëdha kanë qenë të fundit në kalimin në transmetime digjitale, kjo duke marr parasysh penetrimin e internetit dhe

kabllorëve në këto vende, gjë që do të humbte shikues si pasojë e problemeve potencial teknike që do të mund të lindnin në fazat fillestare të digjitalizimit.

Në pyetjen mbi atë se cilat duhet të jene objektivat kryesore që duhet ti permbaje strategjia si dhe si mund të perpilohet ligji ashtu që të jete i zbatueshem dhe i perballueshem nga qeveria dhe nga televizionet, përvoja nga Mbretëria e Bashkuar tregon se pikat kyçe që duhet fokusuar janë niveli i mbulueshmërisë me sinjal, i njejtë apo më i lartë se ai me transmetime analoge, së dyti është përcaktimi i qartë se cili agjencion ka rolin udhëheqës në këtë proces. Strategjia duhet të fokusohet në harmonizimin në mes të të gjitha palëve me interes, përfshi edhe vendimin mbi mënyrën e ndihmesës për grupet që kanë nevojë për përkrahje shtesë. Poashtu është me rëndësi të caktohet nëse kalimi do të bëhet menjëherë apo në faza në bazë të regjioneve. Simulkasti është shumë i kushtueshëm dhe mund ta dëmtojë procesin. U tha se është shumë e rëndësishme që në ligj të futet edhe mekanizmi koordinues për procesin dhe të caktohet një zyrtar i lartë që do ta udhëheq procesin. Çështjet e të drejtave të transmetuesit publik si dhe ato të ndërlidhura me infrastrukturë duhet të adresohen poashtu në ligj.

Në pyetjen mbi aspektin teknik dhe analizën e kriterëve që duhet të përmbushen, përfshi edhe kriteret për paisje, u tha se kushtet teknike duhet të specifikohen në planet për multiplekse. Poashtu një varg rregulloresh duhet aprovur për rregullimin e frekuencave, paisjeve dhe parakushteve të tjera. Këto kushte duhet të jenë shumë specifike edhe në tendërë dhe të përcaktohen nga autoriteti rregullativ dhe ligji. Në dhënien e licensave për multiplekse duhet të përcaktohen specifikacionet teknik të detajuara me fokus të veçantë në ndër-operabilitet në mes të paisjeve dhe operatorëve. Në Koraci procesi është koordinuar nga një agjencion publik i cili ka koordinuar procesin, derisa specifikacionet teknike janë dhënë nga rregullatori i telekomunikacioneve. Përfaqësuesi nga Sllovenia theksoi se kërkesat duhet të jenë të shfrytëzohen SFN (frekuencat efiqente), mirëpo theksoi se nuk ka nevojë të ipen specifikacione për kualitetin e fotografisë dhe shkallën e bitëve (bit rate).

Në pyetjen mbi programet ekzistuese analoge dhe si duhet trajtuar ato, përfaqësuesja nga Mali i Zi tha se transmetuesit publik duhet specifikuar hapsira që do ti lejohet në platformën digjitale, në rastin e Malit të Zi një platformë e plotë. Pjesa e pashfrytëzuar nga transmetuesi publik në kapacitetin e multipleksit është planifikuar të tenderohet. Në Kroaci nuk ka pasur përcaktime të tilla dhe pozicioni i përfaqësuesit nga ky vend ishte se transmetuesit publik duhet ti ofrohet një multipleks vetëm në rast se din dhe ka mundësi të ofrojë përmbajtje programore. Përvoja nga Sllovenia është se multipleksi mund të ndahet dhe njëra pjesë ti ipet transmetuesit publik ndërsa pjesa tjetër tu jepet transmetuesve komercial. Në Britani, nga 6 multiplekset 1 është i dedikuar për shërbimin publik, një për transmetuesit ekzistues analog komercial, një i dedikuar për shërbime në HD dhe tre kanë kërkesa specifike për mbulueshmëri. Përfaqësuesi nga Shqipëria tha se shërbimit publik duhet dhënë hapsira e mjaftueshme në mënyrë që të mbulohen nevojat e shikuesve që nuk kanë mundësi të paguajnë për shërbime, mirëpo duhet pasur parasysh edhe plotësimin e nevojave për programacion në tematika të ndryshme që mund të ofrohen nga transmetuesit komercial.

Për sa i përket kriterëve për përmbajtje programore, kjo çështje u vlerësua si komplekse pasi njerëzit e ndryshëm kanë mendime të ndryshme. këtu ndikon edhe madhësia e tregut dhe aspekti i qëndrueshmërisë ekonomike. Kryesisht shërbimi publik ka rolin e zhvillimit të programacionit kulturor

pasi kanë mjete publike në dispozicion, derisa transmetuesve komercial mund ti lihet hapsira për të lëshuar programacion argëtues.

Përparësitë dhe mangësitë në kalimin në transmetime digjitale

Seanca e dytë e panel diskutimeve u fokusua në aspektet teknike dhe ekonomike në nivel shtetror, atë të industrisë mediatike, biznesit dhe publikut në përgjithësi.

Çështja e parë e diskutuar ishte rreth asaj se a mundet që operatori i rrjetit të jetë njëkohësisht edhe ofrues i përmbajtjes programore. Në Malin e Zi një gjë e tillë është e mundur, mirëpo duhet pasur kujdes që rregullatori i përmbajtjes të ketë kompetenca për të rregulluar këtë çështje me qëllim të evitimit të konflikteve të interesit. Një kërkesë e qartë është se këto dy funksione duhet të operojnë me financa të ndara, gjegjësisht të ketë sistem të ndarë të raportimit financiar. Një sistem i njejtë me Malin e Zi zbatohet edhe në Slloveni, ku operatori i rrjetit mund të jetë edhe ofrues i përmbajtjes. Në Kroaci një gjë e tillë nuk është e lejuar me ligj dhe sipas përfaqësuesit nga Kroaci kjo është praktikë edhe në disa vende të tjera Evropiane. Sipas përfaqësuesit nga Mbretëria e Bashkuar nuk ekziston ndonjë problem që një operator ekonomik të kryej të dy funksionet. Në Mbretëri të Bashkuar janë gjashtë multiplekse të cilat operohen nga katër entitete të ndryshme juridike. Në anën tjetër kemi vetëm një ofrues të shërbimeve të rrjetit transmetues dhe pasi operatori i rrjetës është në fakt monopol ata janë të detyruar që të publikojnë qasjen në rrjet. Në Shqipëri projekt ligji parasheh që një gjë e tillë të jetë e mundur. Atje ligji nuk parasheh licensimin e operatorëve të rrjetit (dallon nga operatori i multipleksit), mirëpo parasheh licensimin e operatorëve që ofrojnë përmbajtje. Në turqi me rrjetin transmetues mund të operojë vetëm një kompani. Mirëpo operatorët e multiplekseve mund të jenë të ndryshëm dhe të kombinohen në mes të atyre publik dhe atyre privat. Operatorët e multiplekseve janë të obliguar të informojnë shikuesit mbi përmbajtjen programore dhe të tregojnë simbolet mbrojtëse të programit.

Në pyetjen se sa kushton procesi i digjitalizimit dhe sa janë mundësitë për të gjetur asistencë financiare, përfaqësuesja nga Mali i Zi tregoi mbi përvojën në vendin e saj ku një pjesë e kostos së pajisjeve transmetuese është blerë përmes një donacioni nga fondet IPA të Komisionit Evropian. Atje projekti ka qenë i dizajnuar asisoji që të ndihmojë transmetuesin e shërbimit public, mirëpo në të njejtën kohë edhe si një përkrahje për të gjithë procesin dhe agjendën e digjitalizimit. Në fakt sipas përfaqësueses nga Mali i Zi nuk është aspak e lehtë që kjo çështje të futet në agjendën e Qeverisë dhe Komisionit Evropian, si zhvillim që duhet përkrahur. Poashtu u tha se ekzistojnë edhe programe të tjera të asistencës nga organizmat ndërkombëtar. Në Mal të Zi ky proces u përkrah edhe nga misioni i OSBE-së. Përvoja nga Kroacia është se ndërtimi i rrjetit dhe dy multiplekseve ka qenë një proces shumë i shtrenjtë për shkak të madhësisë dhe kushteve gjeografike në këtë vend. Poashtu niveli cak i mbulueshmërisë ka rritur koston, e cila sipas përfaqësuesit nga Kroacia do të kishte mundur të jetë shumë më e ulët po të caktohej nivel më i ulët i mbulueshmërisë. Kostoja e ndërtimit të rrjetës në Kroaci ka kapë vlerën prej rreth 40 milion

Euro, ndërsa shpagimi është llogaritur të jetë 10 vite po aq sa është edhe koha e amortizimit të këtyre pajisjeve. Përvoja nga Sllovenia ka qenë e ngjajshme me atë të Kroacisë. Përgjegjësia për krijimin e multipleksit A në Slloveni i është lënë transmetuesit publik, i cili për të arritur shkallën e mbulueshmërisë prej 98% është detyruar të krijojë rrjetin me 160 pika transmetuese. Kostot për rrjetin 1 kanë arritur një vlerë mbi 6 milion Euro, dhe këto më vonë janë ndarë në mes të ofruesve të përmbajtjes programore. Ndërimi i rrjetave digjitale nënkutojnë transmetues SFN të cilët përdorin vetëm një frekuencë dhe janë shumë të shtrenjtë, mirëpo çmimi mund të ulet përmes rrjetave shumë frekuencore (Multi Frequency Networks – MFN) ku transmetuesit mund të operojnë në frekuenca të ndryshme. Një kalkulim i bërë për koston në Shqipëri ka nxjerrë një vlerë investive prej rreth 12-15 milion Euro, dhe atë duke përdorur infrastrukturën ekzistuese të televizionit publik. Për fazën e dytë investive të rrjetit në Shqipëri, që nënkupton zgjerimin edhe nëpër viset ku nuk ka infrastrukture ekzistuese me qëllim të arritjes së mbulueshmërisë mbi 95%, kostoja do të jetë shumë e lartë. Kjo kosto mendohet të mbulohet pjesërisht nga shitje e paisjeve pranuese dhe pjesërisht nga pagesa vjetore për TV që do të rritet nga 4 Euro në vit deri në një vlerë prej rreth 10 Euro në vit për familje në emër të taksës për digjitalizim. Në Turqi shtyllat transmetuese janë ndërtuar nga kompanitë operatore të rrjetit, ndërsa sa i përket paisjeve pranuese, specifikacionet teknike i janë dërguar prodhuesve dhe importuesve të pajisjeve ku janë specifikuar pranuesit në sistemin DVB-T2. Poashtu në Turqi është bërë e obligueshme që të gjithë televizorët e prodhuar apo importuar të kenë modulin e pranuesit DVB-T2 të instaluar në sistem.

Në pyetjen mbi trashigimin e licesave analoge të transmetuesve dhe se a barten ato automatikisht në digjitale, përvojat janë të ndryshme, mirëpo në shumicën e vendeve licesat analoge janë transferuar automatikisht në digjitale në rast se transmetuesit kanë qenë të interesuar për këtë. Ligji Slloven mbi Transmetimet Digjitale ka anuluar të gjitha licesat ekzistuese, derisa transmetuesve ekzistues i është dhënë mundësia për të marrë licesën digjitale dhe për të transmetuar në njërin nga multiplekset. Në Mbretëri të Bashkuar është zbatuar principi i zëvendësimit të licesave analoge me ato digjitale, ku transmetuesve i janë ofruar licesat digjitale si zëvendësim. Këto licesa poashtu kanë specifikuar se kur transmetuesit duhet të ndërprejnë sinjalin analog nëpër regjionet e ndryshme në vend. Një dilemë ligjore e ngritur në Mbretëri të Bashkuar është se tani në vend të transmetuesit frekuencën e përdor operatori dhe kjo mund të shihet jo më si licesë por si një kontratë. Në Shqipëri, edhe pse ligjin i aprovuar në vitin 2007 ka specifikuar se asnjë transmetues nuk do të mund të marrë licesa më të gjata se 5 vite dhe se afati i të gjitha licesave është viti 2012, përsëri ekzistojnë licesa që kanë kohëzgjatje më të madhe. Për këtë arsye pritet që zgjidhja të jetë në konvertimin automatik të të gjitha licesave analoge në ato digjitale. Poashtu, secilit ofrues të përmbajtjes do të sigurohet e drejta për tu mbështetur në platformën digjitale publike. Poashtu një mundësi që po shqyrtohet në Shqipëri është ofrimi i përdorimit/krijimit të një multipleksi të përbashkët në mes të transmetuesve pa pasur nevojë për licesë apo procedurë, dhe kështu të arrihet që këta operatorë të mund të ndërtojnë një platformë. Në anën tjetër në Turqi nuk lejohet transferimi i licesave. E njetja vlen edhe për Malin e Zi ku transmetuesit duhet të kalojnë nëpër një proces tenderimi, mirëpo së paku transmetuesit aktual analog janë të përjashtuar nga pagesa e tarifave edhe për transmetime digjitale së paku gjatë periudhës së simulkastit. Edhe në Kroaci, transmetuesit ekzistues janë detyruar që të kalojnë në transmetime digjitale.

Në pyetjen se si caktohen programet televizive që do të shfaqen në një operator specifik, përvoja nga Mali i Zi është se agjencioni rregullativ duhet të punojë ngushtë me rregullatorin e telekomit dhe përmes kësaj të vendos mbi kapacitetin e një kanali komunikues dhe në bazë të kësaj të caktojë numrin total të programeve, kërkesat e ndryshme varësisht nga natyra e programeve. Në Mal të Zi edhe ligji kërkon të respektohen disa kritere programore (sasia e lajmeve, programeve edukative/arsimore, etj.). Në Kroaci, së pari është bërë vendosja e transmetuesve në Mux. Kriteret kanë qenë të ngjajshme me kriteret analoge (sasia e produkteve, kuotat për punë audiovizuale, kualiteti dhe diversiteti i kontetit) nme qëllim që me këto rregullore të sigurohet diversiteti i përmbajtjes. Në Slloveni secili ofrues i përmbajtjes ishte i detyruar të marrë licensë përmes procesit të tenderimit. Vetë ofruesit e përmbajtjes e zgjedhin multipleksin ku dëshirojnë të emetojnë. Në anën tjeër, në Mbretërinë e Bashkuar kanalet publike dallojnë nga ato komerciale. Për të marr licensën në këtë vend, kanalet duhet të plotësojnë një varg kriteresh para licensimit. Në Shqipëri të gjithë transmetuesit do të kenë mundësi të transmetojnë në njërin nga rrjetet ku ka vend. Operatorët e rinj do të futen në platforma aty ku ka vend. Për sa i përket renditjes së kanaleve në listë, televizionit publik do ti ipet numri 1 në renditje, ndërsa kanalet e tjera ndoshta renditen përmes shortit. Në Turqi, plani është të lejohen transmetuesit publik e pastaj të tjerët. Rradhitja e kanaleve bëhet sipas tenderit, ku çmimet më të ulta marrin vendet e para në listë. Në Kroaci nuk keqiston ndonjë politikë specifike mbi këtë çështje dhe nuk ka politika për licensim të një kanali minoritar, derisa këto kanale do të kenë mundësi të përfshihen në njërin nga multiplekset e krijuara.

Në pyetjen mbi përvijat specifike të licensimit dhe nëse janë licensuar transmetuesit aktual, përvoja nga Sllovenia është se tre kanale komerciale kombëtare kanë kaluar nëpër procesin e tenderimit, ku edhe kanë marr licensat digjitale.

Pastaj u diskutua edhe nevoja për përkrahje të shikuesit fundor dhe përkrahjes për shikuesit nga aspekti psikologjik dhe teknik. Panelistët vlerësuan asistencën për shikuesit si një gjë kruciale ku u tha se do të ishte edhe humbje kohe edhe parash nëse shikuesit nuk do të ishin të kënaqur. Poashtu sa i përket paisjeve pranuese, shikuesit duhet të informohen mbi datat e rëndësishme dhe se çka duhet bërë në këto data, ku mund të marrin përkrahje, etj. Përvoja nga Kroacia ka qenë se edhe përkundër kampanjave gjithëpërfshirëse, qendrave të thirrjes, angazhimit të vullnetarëve për vetëdijësim, përdorimit të performansave dhe qasjes së ndarë nëpër regjione, përsëri ka njerëz që presin momentin e fundit. Një numër i madh i shikuesve në Kroaci ka blerë paisjet pranuese në ditën e fundit të kalimit. Poashtu u tha se fushatat informuese duhet të jenë të planifikuara mirë ashtu që informatat të arrijnë te të gjithë qytetarët. Në këtë drejtim, specifikacionet e paisjeve pranuese janë shumë të rëndësishme ashtu që të evitohet konfuzioni tek shitësit e paisjeve si dhe qytetarët.

Çështja e radhës ishte nëse një transmetues licensohet për transmetime digjitale nga autoriteti rregullativ a i garantohet qasja në multiplekset e licensuara dhe se a mundet operatori i multipleksit ta refuzojë. Sipas panelit një gjë e tillë duhet të vendoset në fillim. Dilemat këtu janë nëse operatorët e multiplekseve duhet lejuar të punojnë të pavarur si biznes. Zakonisht multiplekset duhet pë dorëzojnë një plan mbi ate se çfarë lloje programesh dëshirojnë ti përfshijë në pakon e tyre. Në këtë drejtim konsideratë duhet ti ipet asaj se a do të jenë programet me pagesë apo pa qasje të kushtëzuar, prezenca e kanaleve ndërkombëtare, etj. Të gjitha këto kërkesa duhet të paraqiten në tenderët për operator të multiplekseve apo edhe të rregullohen me ligj. Në Kroaci, të gjitha kanalet ekzistuese janë njohur dhe u

është dhënë e drejta automatike për tu përfshirë në multipleks. Kanalet e reja janë specifike për multipleksin dhe përcaktimi për to bëhet me proces të tenderimit. Në rastin e Koracisë janë mbajtur dy tenderë të ndarë për multipleksin A dhe B. Në Slloveni, secili operator i multipleksit është i obliguar që të inkuadrojë kanalet të cilat kanë marr licensë transmetimi. Në Shqipëri projekligji parasheh që operatorët i platformave janë të detyruar të pranojnë të gjithë, gjë që garanton të paktës se kanalet ekzistuese të licensuara do të jenë prezente në së paku njërin nga platformat (multiplekset) digjitale.

Pasurimi i ofertës programore dhe Dividenda Digjitale

Në seancën e fundit të konferencës u diskutuan çështjet e përmbajtjes programore, politikat kombëtare rreth digjitalizimit dhe dividenda digjitale.

Pyetja e parë e ngritur për panelistët ishte e lidhur me transmetimet digjitale të radio sinjalit. Nga paneli u tha se teknologjia për këtë ekziston nga vitet e nëntëdhjeta. Pozicioni i qeverisë Britanike mbi këtë çështje ka qenë se vendimi mbi kalimin e plotë në radio transmetime digjitale do të merret rreth vitit 2015 dhe atë me një cak që deri atëherë rreth 50% e tregut të këtu kaluar në DAB (Digital Audio Broadcast) sistem. Një problem në këtë drejtim është se radiot në automjete ende nuk kanë kaluar në sistemin DAB dhe për këtë arsye mund të pritet që transmetimet do të vazhdojnë edhe për një periudhë paralelisht në valët FM dhe në DAB. Radio digjitale mund të ekzistojë përkrah radios analoge, mirëpo problemet paraqiten me fragmentimin e spektrit dhe pritet që tranzicioni do të jetë i vështirë. Këtu kemi edhe stadin e dytë të zhvillimit të teknologjisë me DAB+. Radio kanalet sot mund të kompresohen edhe në DVB multiplekse. Në asnjërin nga shtetet prezente në konferencë nuk ekziston plani për kalim të plotë në radion transmetime digjitale, duke mos e trajtuar këtë çështje në strategjitë për digjitalizim si dhe duke mos caktuar asnjë afat fiks.

Për sa i përket rritjes së përmbajtjes programore përmes digjitalizimit, qasjet janë të ndryshme dhe atë prej tentimit për rregullimin e kësaj çështjeje përmes kriterëve të përcaktuar në strategji, ligj apo nëpër proceset e tenderimit, që do të thotë se qeveria dikton se cilat janë nevojat e qytetarëve. Qasja në spektrin tjetër është që kjo çështje ti lihet tregut për ta përcaktuar.

Në pyetjen se çka ndodh pas digjitalizimit dhe cilat janë përfitimet shtesë për shoqërinë, përvojat e panelistëve janë të ndryshme. Në Mbretërinë e Bashkuar benefitet janë të shumta dhe të dukshme. Së pari është numri i shtuar i kanaleve televizive, kualiteti i lartë i fotografisë, ofrimi i shërbimeve interaktive, etj. Poashtu përfitimi i Dividendës Digjitale është i qartë me 14 kanale frekuencore të liruara gjatë procesit të kalimit. Kanalet e liruara nga dividenda digjitale pritet të binë përfitime për qeverinë përmes lëshimit të licensave për rrjetat mobile 4G. Përvoja nga Kroacia është e ngjajshme pasi ka përmbajtje programore të shtuar dhe 2 kanale të reja në multipleksin 2. Mirëpo, përveç përmbajtjes shtesë në multipleksin 3 me programe sportive, biznesi dhe muzike, në realitet sipas përfaqësuesit nga

Kroacia nuk ka pasur ndonjë ofertë drastikisht të shtuar. Sipas tij, nuk priten investime dhe shpenzime shtesë në marketing dhe për këtë arsye tani pritet që sasia e njejtë e parave të ndahet ndërmjet një numri më të madh të përdoruesve. Reklamat janë shtytësi kryesor e ato janë të lidhura me nivelin e shikueshmërisë. Pritjet në Shqipëri janë drejt përmirësimit të kualitetit të fotografisë, rritjes së numrit të kanaleve në dispozicion si dhe shfrytëzimi i dividendës digjitale për zhvillimin e sektorëve dhe shërbimeve të reja.

Në pyetjen se a mund të jetë kalimi në transmetime tokësore ajore digjitale në Kosovë i panevojshëm duke marrë parasysh shkallën e penetrimit të shërbimeve kabllore, përfaqësuesi nga EPRA dhe Kroacia thotë se në realitet nuk mund të pritet që shërbimet kabllore të zëvendësojnë nevojën për shërbime të transmetimit ajror. Kabllimi nëpër fshatra dhe zona të izoluara është i shtrenjtë dhe kthimi në investim i vështirë. Prandaj sipas tij, fibri dhe kabloja nuk mund të zëvendësojnë opsionet e transmetimeve tokësore.

Përfundimisht u diskutua edhe rreth çështjes së shfrytëzimit të dividendës digjitale. Përfaqësuesi nga Mbretëria e Bashkuar thotë se gjatë periudhës së kalimit janë liruar disa kanale të cilat janë planifikuar për shërbimet në 4G (kanale 60-69). Në Mbretërinë e Bashkuar poashtu është liruar edhe brezi tjetër i kanaleve 31-38, mirëpo ende nuk ka ndonjë vendim për shfrytëzimin e këtij brezi. Në Slloveni është vendosur që spektri frekuencor i liruar do të shfrytëzohet për shërbimet e broadband-it mobil dhe mund të shfrytëzohet edhe për futjen e shërbimeve të reja.

Aneksi 1 – Fjala hyrëse nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës – z. Jakup Krasniqi

E nderuara Shefe Ekzekutive e KPM-ës,

Të nderuar mysafirë,

Përfaqësues të rregullatorit të BE-së dhe rajonit,

Zonja dhe zotërinj,

Jam i nderuar që gjendem mes jush, si pjesë e një debati me shtrirje të gjerë gjeografike dhe që bart në vete detyrime të rëndësishme profesionale. Debati për digjitalizimin po na përcjellë një kohë të gjatë, që tregon kompleksitetin e tij. Kjo stërzgjatje po nxjerr në pah diskrepancën e progresit dhe zhvillimit mes rajonit tonë dhe pjesës tjetër të Evropës. Diferenca është e dukshme dhe nevoja për përsheptim është urgjente.

Zonja dhe zotërinj,

Në diskutimet që do të zhvilloni gjatë konferencës, do të dëgjoni se Komisioni i Pavarur i Mediave ka vepruar në vazhdimësi për të qenë në hap me vendet tjera në procesin e digjitalizimit. Komisioni i Pavarur i Mediave ka koordinuar veprimin me institucionet e Kosovës dhe me institucionet homologe në rajon. Ka krijuar mekanizmat e nevojshëm për veprim duket përfshirë potencialin e brendshëm dhe të jashtëm. Por, në takimet e mia me drejtuesit e KPM-së, unë dëgjoj se ata dhe Kosova përballet edhe me probleme specifike. Janë këto përballje me sfida që vendet tjera nuk i kanë. Mospranimi i Kosovës në ITU e vendos Kosovën në pozitë të pabarabartë me të tjerët. I bënë sfidat e Kosovës ndryshe nga ato të vendeve tjera. E zgjeron listën e pamundësive subjektive për Komisionin e Pavarur të Mediave në procesin e digjitalizimit dhe veprimtaritë tjera.

Në botën që jetojmë është vlerë të kemi mospajtime në bindjet që kemi. Por është goditje e të ardhmes së shoqërive kur për çështje burokratike a politike përjashtohen shoqëritë nga proceset që detyrimisht duhet të përfshihen.

Është e papranueshme që të merren në shqyrtim planet dhe strategjitë për rregullim të një pjese të hapësirë së Kosovës nga shtet fqinje, e të përjashtohet plani dhe strategjia e institucionit kompetent për këtë hapësirë, ajo e Komisionit të Pavarur të Mediave të Kosovës. Komuniteti ndërkombëtar mund të jetë i lodhur nga të parit Kosovën ndryshe, por Kosova është në fillimin e rrugës se saj te konsolidimit te shtetit, pavarësisë dhe sovranitetit dhe e vetëdijshme për sfidat që e presin nuk mund të zgjedhë

pritjen, as të mendojë për lodhjen por për zgjidhje maksimale që e vendosin atë krahas vendeve të tjera në barazinë e ekzistencës, përfitimit dhe kontributit në botën tonë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Pavarësisht gjendjes dhe rrethanave është një moment që duhet shfrytëzuar maksimalisht. Jam i sigurt se në kohë të duhur do të ndërmerren veprime të duhura nga mekanizmat përgjegjës ndërkombëtar që Kosova të mos shihet ndryshe nga të tjerët në procesin e digjitalizimit. Ajo që na mbetet neve është kryerja me sukses dhe në afat e detyrimeve tona. Këto veprime nënkuptojnë përgatitje me kohë të industrisë që implikon kalimi nga brezi frekuencor analog në atë digjital. Është kjo një gamë e gjerë e veprimeve që ju si profesionistë i shihni si pjesë të gjithë këtij mozaiku, përfshirë standardizimin, licencimin, bashkëpunimin, shpërndarjen, konsumimin, etj. Prania juaj këtu është një sinjal inkurajimi për angazhim të përbashkët në një kapërcim të suksesshëm nga plani i vjetër frekuencor në atë të ri. Është e qartë për të gjithë se sukcesi i kësaj veprimtarie është investim në standardin e qytetarëve tanë, audiencës suaj. Sot të gjithë jemi gjithnjë e më shumë shfrytëzues të këtyre zbulimeve dhe avancimeve teknologjike, pavarësisht sa i njohim apo sa kemi interesim për to.

E kuptoj se në këtë kohë të zhvillimit enorm teknologjik, për shumë drejtues të botës së medias dhe rregullatorëve për media paraqiten sfida të shumta. Paraqiten situata dhe gjendje që kërkojnë përgjigje dhe veprime inovative për të parandaluar shfrytëzimin e teknologjisë dhe medias për projeksione negative dhe të dëmshme për shoqëritë. Kjo e bënë më të rëndësishëm rregullimin e përgjegjshëm dhe të shpejtë të politikave dhe standardeve të pranueshme për mediat edhe në kohën e digjitalizimit, por pa cenuar vlerat e demokracisë në planin e lirisë së shprehjes dhe të fjalës. Aq më tepër kur merret parasysh fakti se avancimi teknologjik përveç transformimeve në kuptimin teknik ka transformuar edhe rolin e qytetarëve në debatet dhe shkëmbimin e informatave.

Kosova synon të jetë pjesë e këtyre standardeve teknologjike dhe njëkohësisht pjesë e standardeve të avancuara të interaktivitetit, pjesëmarrjes qytetarë, zhvillimit dhe lirisë së medias.

Pres me padurim të dëgjoj për dobitë e kësaj konference, sukseset e procesit të digjitalizimit dhe koordinimit tuaj më të madh në përballimin e sfidave të përbashkëta që na paraqiten në fillim të këtij mileniumi.

Aneksi 2 – Fjalimi i Shefes Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media

I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Jakup Krasniqi

Të nderuar kolegë nga autoritetet rregullatore Britanisë së Madhe, Kroacisë, Malit të Zi,

Maqedonisë, Sllovenisë, Shqipërisë dhe Turqisë

Të nderuar përfaqësues të subjekteve të licencuara nga KPM,

Të nderuar të pranishëm,

Jam e nderuar t'ju drejtohem në fillim të kësaj konference, që për qëllim ka shkëmbimin e përvojave tona në procesin e komplikuar, sfidues por shumë të rëndësishëm të digjitalizimit të transmetimeve televizive. Takimi në këtë konferencë për mua dhe KPM-në është mjaft domethënës meqenëse jemi palë që po japim një kontribut në bashkërendimin e veprimeve për digjitalizimin në Evropën Jug-Lindore. Po kontribuojmë në një proces që i tejkalon kufijtë shtetërorë e gjeografik dhe imponon përafrimin e përvojave manaxhuese e profesionale. Për më tepër, ky proces imponon bashkërendimin e veprimeve deri në momentin kur transmetimet në vendet tona do t'i avancojmë dhe t'i bëjmë pjesë të standardit evropian të transmetimit.

Të nderuar mysafirë,

Komisioni i Pavarur i Mediave tashmë që katër vite është i angazhuar në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për procesin e digjitalizimit. Kjo është hera e tretë që me iniciativën tonë realizojmë takime në nivele të ndryshme bashkëpunimi përtej-kufitar në synimin tonë për të hartuar një strategji adekuate kompatible që plotëson nevojat e qytetarëve të Kosovës, dhe në koordinim me vendet fqinje. Në takimin e realizuar në verë të vitit 2008, synonim të përcaktonim hapat fillestarë që Kosova duhet të ndërmerre për të filluar procesin e digjitalizimit. Mund të them se ajo ishte e suksesshme njëjtë si konferenca e dytë, një vit më vonë, që rezultoi me shkëmbimin e përvojave me vendet e rajonit - gjithnjë nën preokupimin e përbashkët, procesin e tranzicionit në transmetim digjital.

Nga ky takim, KPM doli me idenë për krijimin e dy mekanizmave koordinues:

Një mekanizëm të brendshëm, i cili do të duhej të ishte në mes të palëve me interes në Kosovë, dhe

Mekanizmi tjetër koordinues rajonal, i cili do të mund të iniciohej ndoshta me propozimin e Kosovës dhe do të përfshinte autoritetet përgjegjëse nga vendet e rajonit, të cilat mund të preken nga pasojat e mos koordinimit të duhur për shfrytëzimin e spektrit frekuencor. Sidoqoftë, mekanizmi i brendshëm

koordinues, duhet t'i paraprij çfarëdo mekanizmi rajonal dhe besojmë që këtë koordinimin e kemi në rrugën e duhur nëse I referohemi hapave që u ndërmorën në 2010 nga Këshilli I KPM-së me krijimin e pesë grupeve punuese të cilat udhëhiqen nga KPM dhe përfaqësohen nga të gjitha institucionet relevante kosovare, mediat tona dhe shoqëria civile. mediave dhe të shoqërisë civile. Synim dhe mision I këtyre grupeve është krijimi i kornizës ligjore, teknike, programore dhe ekonomiko-shoqërore të kalimit në transmetim digjital, kurse grupi i pestë është caktuar që të bëjë informimin por edhe edukimin e publikut për të qenë të gatshëm të pranojnë dhe të jenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm nacional.

Sot jemi këtu për të vazhduar diskutimin tonë pas katër viteve që kur filluam të planifikonim se çfarë duhet bërë. Duken shumë dhe në një situatë tjetër patjetër që do të pritej që në sot të prezantonim para publikut kosovar dhe kolegëve evropianë më shumë detaje e rezultate për digjitalizimin e Kosovës. Por, KPM ka 18 muaj që nuk ka Këshill për shkak të mos emërimit të anëtarëve dhe për 18 muaj KPM funksionon vetëm në kuadër të Zyrës Ekzekutive e cila përkundër përkushtimit për të realizuar detyrimet me të cilat është ngarkuar me ligj, nuk mund të marrë vendime dhe të finalizojë strategjinë.

Sot jemi dy muaj pas miratimit të ligjit të ri për Komisionin e Pavarur për Media dhe jemi në pritje që brenda pak ditësh Kuvendi të emërojë anëtarët e Komisionit për të funksionalizuar plotësisht institucionin.

Këto zhvillime dhe diskutimet e këtyre dy ditëve të konferencës sonë do të jenë shtytje për ne që me institucionet relevante të shtetit të Kosovës dhe komunitetin medial të përfundojmë strategjinë për kalim në transmetim digjital tokësor televiziv të cilën e miraton Qeveria. Në bazë të kësaj strategjie pastaj do të hartohet ligji për digjitalizim për t'u miratuar nga Kuvendi.

Të nderuar pjesëmarrës të këtij takimi,

Jemi të vetëdijshëm se ende kemi shumë për të bërë. Aq më tepër që Kosova për dallim prej të gjithë shteteve fqinje, e ka një sfidë më tepër, dhe atë sfidë shumë serioze, për shkak të pamundësisë së Kosovës që të anëtarësohet në ITU dhe të modifikojë me hapa më të shpejtë planin në atë mënyrë që siguron mbulueshmëri të përfunduar të tërë territorit.

Por, besojmë se me potencialin e brendshëm, angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive të institucioneve tjera dhe komunitetit medial e shoqërisë civile, si dhe në koordinim me institucionet simotra në rajon, do të arrijmë me sukses ta përmbyllim tranzicionin e brezit frekuencor të transmetimeve nga ai analog në digjital.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe uroj që konkluzat dhe rekomandimet kësaj konference të prodhojnë rezultatet e pritura.

Naile Selimaj-Krasniqi

Shefe Ekzekutive

Komisioni i Pavarur i Mediave

Aneksi 3 – Agjenda e Konferencës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

DIGJITALIZIM

I TOKËSOR TELEVIZIV

*STRATEGJITË NACIONALE PËR KALIM NGA TRANSMETIMI ANALOG NË TRANSMETIM
DIGJITAL*

PRAKTIKAT EVROPIANE & RAJONALE

28 qershor 2012

09:30 - 10:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

Moderator: Bersant Disha

10:00 - 10:15 *Hapja e konferencës*

Fjalimi nga **z. Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit

10:15 - 10:45 *Aktivitetet dhe puna e KPM-së rreth strategjisë së kalimit në transmetim digjital në Kosovë*

znj. Naile Selimaj Krasniqi, Shefe Ekzekutive e KPM-së

10:45 - 11:15 *Digjitalizimi dhe mediat në Kosovë*

z. Mentor Shala, zv. Drejtor Gjeneral, Radio Televizioni i Kosovës,

z. Visar Hoti, Përfaqëues, AMPEK

11:15 - 11:30 Diskutim i hapur

11:30 - 11:45 Pauza për kafe

11:45 - 13:00 *Nga transmetimi analog në transmetim digjital tokësor – Perspektiva e përbashkët e Bashkimit Evropian*

11:45 – 12:15	z. Damir HAJDUK, folës kryesor, Nënkyetar i Bordit të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullative (EPRA)
12:15 – 12:30	z. Andre DUMBRECK, ekspert OFCOM, BRITANI E MADHE
12:30 – 13:00	Pyetje dhe Përgjigje
13:00 – 14:00	Dreka
14:00– 15:30	<i>Nga transmetimi analog në atë digjital - përvoja regjionale</i> PANELISTË z. Pirro BRACO, Drejtor i Drejtorisë Teknike - Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit, SHQIPËRI
Pyetje dhe Përgjigje	z. Damir HAJDUK, Anëtar i Këshillit, Agjensioni për Media Elektronike, KROACI
Pyetje dhe Përgjigje	znj. Jadranka Filipovic-VOJVODIC, Zëvendës Drejtoreshë, Agjencia për Mediat Elektronike, MALI I ZI
Pyetje dhe Përgjigje	
15:30 – 15:45	Pauza për kafe
15:45 – 17:15	<i>Paneli: Nga transmetimi analog në atë digjital - përvoja e përbashkët regjionale (vazhdim)</i> z. Selver HAJDINI, Anëtar, Këshilli i Radiodifuzionit MAQEDONI
Pyetje dhe Përgjigje	z. Igor FUNA, Ekspert për teknologji digjitale, APEK, SLLOVENI
Pyetje dhe Përgjigje	z. Erdem CAKMAK, ekspert për licencim, Këshilli i Lartë për Radio dhe Televizion, RTÜK, TURQI
Pyetje dhe Përgjigje	
17:15 - 17:30	Përfundimet e punës së ditës së parë të konferencës
19:30	Darka

Villa Gërmia, Prishtinë

29 qershor 2012

09:30 – 11:45

PANELI 1: Rregullimi i transmetimit në periudhën e digjitalizimit

Aspekti ligjor dhe regjimi i licencimit në transmetimin digjital

Folës: anëtarët nga autoritetet rregullatore nga Britania e Madhe, Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Sllovenia dhe Turqia

Pyetje dhe Përgjigje

11:45 – 12:00

Pauza për kafe

12:00 – 13:30

PANELI 2: Përparësitë dhe mangësitë në kalimin në transmetim digjital

Aspektet teknike dhe ndikimi ekonomik në nivelin shtetëror, të industrisë mediale, bizneseve dhe publikut

Folës: anëtarët nga autoritetet rregullatore nga Britania e Madhe, Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Sllovenia dhe Turqia

Pyetje dhe Përgjigje

13:30 – 14:30

Dreka e servuar në Hotel Emerald

14:30 – 15:15

PANELI 3: Pasurimi i ofertës programore

Çështjet e përmbajtjes dhe përparësia nga digjitalizimi për media dhe publikun

Folës: anëtarët nga autoritetet rregullatore nga Britania e Madhe, Shqipëria, Kroaci, Mali i Zi, Maqedonia, Sllovenia dhe Turqia

Pyetje dhe Përgjigje

15:15 – 15:30

Pauza për kafe

15:30 – 16:30

DIVIDENTA DIGJITALE

Politikat nacionale

Folës: anëtarët nga autoritetet rregullatore nga Britania e Madhe, Shqipëria, Kroaci, Mali i Zi, Maqedonia, Sllovenia dhe Turqia

Pyetje dhe Përgjigje

16:30 – 16:45

Rekomandimet nga diskutimet e panelit të ditës së dytë

30 qershor 2012

Përmbyllja e konferencës

Aneksi 4 - Prezentimet e folësve në konferencë

Prezentimet nga folësit në konferencë janë në formatin power point dhe mund të sigurohen me kërkesë nga Komisioni i Pavarur për Media.